

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**



**FAKULTETI I DREJTËSISË**  
**FACULTY OF LAW**  
**ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ**

**TEZA:**

**“REGJISTRI PËR PERSONA TË DËNUAR PËR VEPRA PENALE TË KEQPËRDORIMIT SEKSUAL TË FËMIJËVE DHE PEDOFILI NË RMV (2012-2018)”**

**Kandidat:**  
**Rina Mirta**

**Mentor:**  
**Doc. Dr. Vedije Ratkoceri**

**Mars, 2020**



## **Falënderim**

Falënderime të sinqerta dhe mirënjohje për udhëheqësen time shkencore Doc.Dr.Vetdije Ratkoceri për motivimin dhe mbështetjen e pakursyer përmes këshillave dhe sugjerimeve profesionale gjatë realizimit të këtij punimi. Inkurajimi dhe vëmendja e së cilës më mundësoi që më së miri të zhvilloj kuptimin e këtij studimi që nga faza fillestare e deri në fazën përfundimtare. Gjithashtu falënderoj të gjithë profesorët e këtij universiteti për kontributin e tyre gjatë këyre viteve.

Mirënjohje e thellë për familjen dhe prindërit e mi të cilët më mbështetën dhe më ndihmuan gjatë gjithë kohës së studimeve të magjistraturës.

Falënderime të përzemërta për miqtë dhe shoqërinë për këshillat, kurajon dhe impaktin e dhënë gjatë gjithë kohës.

Respekt për të gjithë Ju që më ishit pranë.

***Rina Mirta***

## PËRMBAJTJA

Abstrakt.....	1
Апстракт .....	2
Abstract.....	3
Hyrje.....	4
Qëllimi i hulumtimit .....	6
Hipotezat.....	7
Metodologjia e hulumtimit.....	8

### KAPITULLI I

#### ABUZIMI SEKSUAL I FËMIJËVE DHE PEDOFILIA

1. Vështrime të përgjithshme .....	9
2. Nocioni i abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë .....	12
2.1 Karakteristikat e kryerësve .....	14
3. Abuzimi seksual i fëmijëve dhe pedofilia në RMV .....	15
4. Masat parandaluese të abuzimit seksual dhe pedofilisë.....	19
4.1 Masat parandaluese në RMV .....	22

### KAPITULLI II

#### Historiku i regjistrave të abuzuesve seksual

1. Vështrime të përgjithshme .....	29
2. SHBA.....	30
3. Mbretëria e Bashkuar .....	32
4. Korea e Jugut.....	34
5. Maldivet .....	35

## KAPITULLI III

### Regjistri për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV

1. Vështrime të përgjithshme .....	36
2. Ligji mbi regjistrin e veçantë .....	41
3. Web portali <a href="http://www.registarnapedofili.com">www.registarnapedofili.com</a> .....	43
4. Veprat penale e Kodit Penal të përfshira në Regjistrë.....	46
4.1 Dhunimi (neni 186 paragrafi 2) .....	47
4.2 Abuzim ndaj personit të paaftë (të pafuqishëm) (neni 187 paragrafi 2).....	47
4.3 Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet (neni 188).....	47
4.4 Abuzim me keqpërdorim të pozitës (neni 189 paragrafi 2).....	48
4.5 Kënaqja e epsheve seksuale para tjetrit (neni 190 paragrafi 2 dhe 3) .....	48
4.6 Prostitucioni i fëmijëve (neni 191-a).....	49
4.7 Tregimi i materialeve pornografike fëmijës (neni 193).....	49
4.9 Mashtrim për abuzim ose veprim tjetër seksual ndaj fëmijëve të cilët nuk kanë mbushur 14 vjet (neni 193-b).....	51
4.10 Incesti (neni 194 paragrafi 2) .....	52
4.11 Tregti me fëmijë (neni 418-g).....	53
5. Regjistri dhe cënimi i të drejtave të njeriut për kryerësit.....	54

## KAPITULLI IV

### Studim empirik

1. Të dhënat statistikore në Regjistrin për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV për periudhën 2012-2018.....	58
1.1 Lloji i veprës penale.....	58
1.2 Të dhënat gjinore .....	60
1.3 Të dhënat rreth vendbanimit të kryerësve .....	61
1.4 Llojet e dënimeve të shqiptuara ndaj kryerësve.....	63
Përfundim dhe rekomandime.....	66
Literatura e shfrytëzuar: .....	71

## **Abstrakt**

Jeta e një të riu reflekton të kaluarën e tij si diçka e pashmangshme nga tërësia e jetës së njeriut. Sot, abuzimi seksual i fëmijëve paraqet një fenomen shqetësues në të gjithë botën përfshirë këtu edhe fëmijët e të gjitha moshave dhe gjendjes socio-ekonomike.

Abuzimi seksual i fëmijëve, është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe etike. Ky fenomen paraqet një nga format më të rënda dhe ekstreme të abuzimit ndaj fëmijëve, lë gjurmë e pasoja afatgjata tek fëmijët, shkakton dëm fizik e psikologjik të rëndë, si dhe ndikon në zhvillimin dhe të ardhmen e fëmijës. Një ndër format efikase për parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve në shoqëri është regjistrimi i personave të dënuar për vepra penale të pedofilisë në një regjistër të posaçëm, në të cilin regjistër ka qasje publiku i gjerë. Një hap i tillë është ndërmarrë edhe nga Republika e Maqedonisë Veriore (RMV) në vitin 2012.

Cila ishte iniciativa për krijimin e këtij regjistri, si menaxhohet ky regjistër dhe çfarë të dhënash ofrohen për publikun, janë temat kyçe të shtjelluara në këtë hulumtim.

Në këtë studim, në mënyrë të përgjithësuar është trajtuar abuzimi seksual i fëmijëve si dhe masat parandaluese të kësaj dukurie. Rëndësi të veçantë do t'ju kushtohet shteteve të cilat kanë krijuar regjistër të hapur për abuzimin seksual të fëmijëve, si: SHBA-të, Korea e Jugut dhe Maldivet.

Abuzimi seksual i fëmijëve është një fenomen shumë më i përhapur se sa mendojnë njerëzit. Mungesa e punimeve të këtij lloji paraqet një fakt shqetësues në vendin tonë. Shkak për mungesën e të dhënave të sakta se sa është i pranishëm ky fenomen është mosdenoncimi i këtyre incidenteve. Nisur nga efektet paralajmëruese të rrezikut, parandalimi i keqtrajtimit të fëmijës duhet të bëhet prioritet, t'ju ofrojmë atyre përkrahje humane në çastet e shpresës së humbur, në çastet e përshkuara nga ankthi dhe depresioni, t'i aftësojmë për t'u mbrojtur nga rrethanat kërcënuese dhe t'u kundërvihen këtyre dukurive devijuese në shoqëri.

**Fjalë kyçe:** abuzimi seksual i fëmijëve, pedofilia, regjistri online, preventiva, sanksionet

## Апстракт

Животот на една млада личност го рефлектира неговото минато како нешто неизбежно од целокупниот живот на човекот. Денес, сексуалната злоупотреба на деца е загрижувачки феномен ширум светот, вклучувајќи ги децата од сите возрасти и нивниот социо-економски статус. Сексуалната злоупотреба на децата е спротивно на законските и етичките одредби. Овој феномен е една од најтешките и екстремните форми на злоупотреба на децата, има долготрајни ефекти врз децата, предизвикува сериозни физички и психолошки повреди и влијае на развојот и иднината на детето. Една од најефикасните форми на превенција на сексуална злоупотреба на деца во општеството е регистрација на лица осудени за казни за педофилија во посебен регистар, што е достапно за пошироката јавност. Таквиот чекор го презеде и Република Северна Македонија (PCM) во 2012 година.

Која беше иницијативата да се создаде овој регистар, како се управува овој регистар и кои податоци се достапни за јавноста, се клучните теми дискутирани во ова истражување.

Во оваа студија, генерално се третира сексуална злоупотреба на децата и превентивните мерки на овој феномен. Особено значење ќе им се даде на земјите што воспоставија отворен регистар за сексуална злоупотреба на деца, како што се САД, Јужна Кореја и Малдиви.

Сексуалната злоупотреба на децата е многу распространета појава отколку што мислат луѓето. Недостатокот на истражувања од ваков вид е загрижувачки факт кај нас. Причината за недостаток на точни податоци за застапеноста на овој феномен е непријавувањето на овие инциденти. Со оглед на предупредувачките ефекти на ризикот, спречувањето на малтретирање кај децата треба да биде приоритет, нудејќи им човечка поддршка во време на безнадежност, во време на анксиозност и депресија, овозможувајќи им да се заштитат од заканувачки околности и спротивставување на овие девијантни појави во општеството.

**Клучни зборови:** сексуална злоупотреба на деца, педофилија, регистар онлине, превенција, санкции

## **Abstract**

The life of a young man reflects his past as something inevitable from the totality of human life. Today, sexual abuse of children is a worrying phenomenon worldwide, including children of all ages and socio-economic status.

Child sexual abuse is contrary to the ethical and legal provisions. This phenomenon is one of the most severe and extreme forms of child abuse, traces the long-term consequences in children, causes severe physical and psychological harm, as well as affect the development and future of the child. One of the effective forms of prevention of sexual abuse of children in society is the registration of people convicted of child sex offenses in a special register, the register in which the public has access. Such a step is taken by the Republic of North Macedonia (RNM) in 2012.

What started as an initiative for the creation of this registry, how is managed the registry and what data is available to the public, are key topics discussed in this research. In this study, in a general way it is handled sexual abuse of children and preventive measures of this phenomenon. Of particular importance will be given to countries that have created public register for sexual abuse of children, such as USA, South Korea, and Maldives.

Sexual abuse of children is a lot more common than people think. Lack of works of this kind presents a disturbing fact in our country. Due to the lack of accurate data than it is present this phenomenon is not reporting these incidents. Given the hazard warning effects, prevention of child abuse should become a priority, provide them with humanitarian support in moments of lost hope in moments overwhelmed by anxiety and depression, empower them to protect themselves from the threatening circumstances and to oppose these deviant phenom in society.

**Keywords:** child sexual abuse, pedophilia, online registry, prevention, sanctions



## Hyrje

Fëmijët dhe të drejtat e tyre janë me një rëndësi të veçantë kushtetuese dhe sociale. Garantimi i mbrojtjes së tyre nga shfrytëzimi apo abuzimi është një nga detyrat më të vështira në veprimtarinë e respektimit të të drejtave të tyre.

Abuzimi seksual i fëmijëve si dukuri e rrezikshme, me pasoja të rënda dhe afatgjate si për viktimat ashtu edhe për të afërmit dhe familjet e viktimave, kërkon një trajtim serioz nga shoqëria e veçanërisht nga institucionet shtetërore. Shtetet duhet të ndërmarrin të gjitha masat preventive dhe represive me qëllim që në mënyrë sa më efikase të luftojnë dhe parandalojnë veprat penale të abuzimit seksual të fëmijëve.

Trauma shkakton pasoja të rënda tek fëmijët, pasoja të cilat përveç se dëmtojnë jetën dhe zhvillimin e fëmijëve në të ardhmen japin efekte negative në shoqërinë ku këta fëmijë jetojnë, efekte negative në familjet që krijojnë apo në mjediset ku do të punojnë në të ardhmen.

Përmes këtij punimi të magjistraturës do të analizohet dhe elaborohet **Regjistri për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV**, si masë parandaluese për viktimizimin e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga ky fenomen. Nevoja për krijimin e regjistrit të tillë u paraqit në bazë të numrit të rritur të personave që përsërisin këto vepra penale. Qëllimi i këtij regjistri është sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve nga çfarëdo lloj abuzimi, për ta rritur nivelin e kujdesit dhe të parandalimit nga ana e prindërve të tyre. Qëllimi i Ligjit dhe zbatimi i tij është sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi seksual dhe pedofilia përmes arritshmërisë së informatave për personat të cilët jetojnë në rrethin e tyre, ndërkaq të cilët janë dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me abuzimin seksual të personave të mitur dhe pedofili.

Ky punim është strukturuar në katër kapituj, duke filluar nga kapitulli i parë me vështrime të përgjithshme të veprës së abuzimit seksual, çka në të vërtetë paraqet kjo dukuri, sa është e prezente në shoqërinë tonë dhe në vendet më të zhvilluara të botës, si ndikon te fëmijët kjo dukuri, kush janë kryerësit dhe çfarë karakteristika kanë ato dhe në fund janë analizuar masat parandaluese që mund të ndërmerren për reduktimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve. Në kapitullin e dytë rëndësi të veçantë i është kushtuar regjistrave të abuzimit seksual ndaj

fëmijëve në disa shtete duke veçuar shtetet të cilat kanë publikuar regjistër të hapur për të gjithë, si SHBA-ja, Korea e Jugut dhe Maldivet, ndërsa Mbretëria e Bashkuar dallohet nga këto nga që ka të paaritshme të dhënat për personat e dënuar për këto vepra penale. Kapitulli i tretë do të orientohet në drejtim të temës thelbësore, gjegjësisht do të shpjegohet krijimi dhe funksionimi i Regjistrit për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV, do të trajtohet ligji i veçantë për këtë regjistër, veprat penale në Kodin Penal të cilat janë përfshirë në Regjistër si dhe cënimi i të drejtave të kryerësve dhe privatësisë së tyre. Kapitulli i katërt do t'i referohet të dhënave statistikore të regjistrit të siguruar nga faqja online e regjistrit, i cili është i arritshëm për të gjithë, ku është publikuar emri dhe mbiemri i kryerësit, data e lindjes, adresa ku jeton kryerësi, vepra penale për të cilën është dënuar dhe fotografia. [www.registarnapedofili.com](http://www.registarnapedofili.com)

## Qëllimi i hulumtimit

Fëmijët kërkojnë gjithnjë mbrojtje të veçantë si në fushën private të shtëpisë deri tek hapësirat publike të shkollës, institucioneve të burgimit, etj. Ditët e sotme ata i nënshtrohen dhunës dhe janë të viktimizuar në të gjitha sferat e jetës së tyre. Abuzimi seksual me fëmijët është shndërruar në një realitet të dhimbshëm në botën ku jetojmë. Ai është një fenomen shumë herë më i përhapur seç mendojnë njerëzit. Abuzimi seksual i fëmijëve është një problem serioz, për të cilin duhet ndërmarrë masa efektive për ta luftuar atë. Duhet pasur parasysh se të flitet hapur për këtë problem nuk është një temë "tabu" dhe se denoncimi i këtyre rasteve nuk është turp apo përkeqësim i gjendjes së viktimës, ndërkaq në këtë mënyrë do të mund të zvogëlohet "numri i errët" dhe të dënohen kryerësit.

Regjistrin për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV është krijuar që nga viti 2012, i publikuar në internet për të gjithë. Qëllimi për ekzistimin e këtij regjistri është preventiv, mbron fëmijët, nën kushtet dhe në procedurën e përcaktuar me ligj.

Hulumtimi do të bazohet kryesisht në sqarimin e faktit se "Regjistrin për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV" luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e viktimizimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga ky fenomen, si dhe është i domosdoshëm për të penguar recidivizmin e kryerësve.

Mungesa e hulumtimeve të këtij lloji paraqet një mëngësi tjetër në shoqërinë tonë. Synim i punimeve të tilla është informimi dhe ndërgjegjësimi i të gjithë qytetarëve për seriozitetin e këtij problemi, si për predispozitat e viktimave, ashtu edhe për autorët e krimit.

## Hipotezat

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve dhe pedofilia paraqet një sfidë permanente që duhet luftuar dhe parandaluar në mënyrë sa më efikase në çdo shtet e shoqëri bashkëkohore. Një ndër format efikase për parandalimin e pedofilisë në shoqëri konsiderohet regjistrimi i personave të dënuar për vepra penale të pedofilisë në një regjistër të posaçëm, në të cilin regjistër ka qasje publiku i gjerë. Ky regjistër është formuar edhe në RMV, si masë parandaluese për veprimet e mundshme të këtyre personave.

Si hipotezë kryesore do të kemi si vijon:

- Regjistri për persona të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV është masë parandaluese për viktimizimin e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga ky fenomen.

Për të qenë e kuptuar hipoteza kryesore do të kemi nevojë për hipoteza ndihmëse siç janë:

- Regjistri për persona të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV është i domosdoshëm për të penguar recidivizmin e kryerësve.
- Regjistri për persona të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV ofron ndihmë prindërve, kujdestarëve dhe personave të tjerë që janë përgjegjës për fëmijët që të identifikojnë rreziqet potenciale për fëmijët e tyre.
- Publikimi i të dhënave të kryerësve në Regjistrin për persona të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV nuk përbën shkelje të lirive dhe të drejtave të këtyre personave.

## Metodologjia e hulumtimit

Për hulumtimin, kërkimin dhe studimin e rasteve lidhur me këtë punim do të shfrytëzohen këto metoda:

**Metoda normative** është përdorur për të njohur dhe analizuar dispozitat ligjore të legjislacionit të RMV për abuzimin seksual të fëmijëve dhe pedofili. Përmes kësaj metode kemi arritur të njohim sistemin ligjor në RMV në lidhje me abuzimin seksual të fëmijëve.

**Metoda krahasuese** do të zbatohet me qëllim që të bëjmë krahasimin e regjistrave të kësaj natyre ku është prezent ky regjistër (SHBA, Kore e Jugut dhe Maldive, ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar kemi regjistër mirëpo jo të shpallur për publikun). Do të analizohen dhe krahasohen rastet e Megan Case, Adam John Walsh, Jacob Wetterling, Sarah Payne. Sipas të dhënave nga Regjistri për persona të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV, do të bëjmë krahasimin e të dhënave të kryerësve në qytetet e ndryshme të RMV dhe në periudha të ndryshme kohore.

**Metoda statistikore** do të përdoret për mbledhjen, përcjelljen dhe pasqyrimin e të dhënave numerike të cilat do të fitohen gjatë hulumtimit nga Regjistri i veçantë për keqpërdorimin e fëmijëve dhe pedofili. Të dhëna statistikore poashtu do të sigurojmë edhe nga Enti shtetëror i statistikës dhe Ministria e punës dhe politikës sociale.

**Metoda historike** është përdorur për të hulumtuar historikun e publikimit të të dhënave të kryerësve të abuzimit seksual të fëmijëve në SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Korenë e Jugut, Maldivet, si dhe në RMV. Në të njejtën kohë do të analizojmë prezencën e abuzimit seksual në të kaluarën si një fenomen i njohur që nga koha e lashtë.

**Intervista** është një nga metodat e përdorura në këtë punim. Intervista do të realizohet me Znj. Ellka Todorova, administratore e lartë në Ministrinë e punës dhe politikës sociale, në Departamentin për mbrojtje shoqërore-familjare dhe juridike të fëmijëve dhe familjes, e cila merret me mbrojtjen e fëmijëve nga viktimizimi i abuzimit seksual, masat parandaluese të këtij fenomeni, mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave nga kjo dukuri. Nga Enti për punë sociale do të kontaktojmë me Znj. Nevena Petrovska, profesoreshë e shkencave pedagogjike, e cila merret me azhurimin e të dhënave në Regjistër në bashkëpunim me Ministrinë e punës dhe politikës sociale.

# KAPITULLI I

## ABUZIMI SEKSUAL I FËMIJËVE DHE PEDOFILIA

### 1. Vështrime të përgjithshme

Në shoqërinë e ditëve të sotme abuzimi është një ndër problemet më të rënda, veçanërisht kur bëhet fjalë për abuzimin seksual ndaj fëmijëve. Fëmijët janë e ardhmja e një shoqërie, konsiderohen si qenie më e pafajshme në botë. Ato meritojnë kushte të volitshme, siguri dhe mbrojtje të pa kursyer si nga prindërit, rrethi familjar, shoqëria dhe institucionet shtetërore.

Abuzimi seksual i fëmijëve është bërë një fenomen tejet shqetësues si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Konsiderohet si një ndër format më të rënda dhe më ekstreme të abuzimit ndaj fëmijëve, duke pasur parasysh pasojat afatgjata që pengojnë në zhvillimin e personalitetit, socializimin me të tjerët si në moshën fëmijërore por edhe në moshën e adoleshencës dhe moshën madhore.

Abuzuesi përdor pushtetin e tij tek fëmija dhe marrëdhënien specifike për ta shfrytëzuar atë. Mbi të gjitha, abuzuesi dhunon besimin e fëmijës, element ky që e bën abuzimin seksual edhe më shkatërrues për psikikën e fëmijës.<sup>1</sup>

Sipas Këshillit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (1999): “Abuzimi seksual i fëmijëve është përfshirja e një fëmije në një aktivitet seksual për të cilin fëmija nuk është i përgatitur fizikisht, të cilin fëmija nuk e kupton plotësisht, është i/e paaftë të japë miratimin, ose që shkel ligjet apo tabutë sociale të shoqërisë. Abuzimi seksual i fëmijëve ndodh nga veprimi mes një fëmije dhe një të rrituri/apo një fëmije tjetër që ka moshë apo zhvillim të përgjegjshëm, veprim ky i qëllimshëm për të plotësuar dhe kënaqur nevojat e personit tjetër apo fëmijës tjetër. Kjo mund të përfshijë (por nuk është e kufizuar): nxitje apo detyrim i fëmijës për t’u përfshirë në

---

<sup>1</sup> Shehu. E & Gramo.A, Dhuna me bazë gjinore - Manual për punonjësit e mjeksisë, [http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania\\_Manual%20for%20health%20workers%20in%20Albanian.pdf](http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania_Manual%20for%20health%20workers%20in%20Albanian.pdf)

<sup>2</sup> 1999 WHO Consultation on Child Abuse Prevention, [https://www.who.int/violence\\_injury\\_prevention/resources/publications/en/guidelines\\_chap7.pdf](https://www.who.int/violence_injury_prevention/resources/publications/en/guidelines_chap7.pdf)

ndonjë veprim seksual të paligjshëm; shfrytëzimi i fëmijës për prostitucion apo ushtrime të tjera të paligjshme; shfrytëzimi i fëmijëve për shfaqje apo materiale pornografike”.<sup>2</sup>

Keqpërdorimi seksual i fëmijëve është një fenomen global, shtrirja e të cilit nuk dihet saktësisht për shkak të vështirësisë që kanë fëmijët të raportojnë dhe të denoncojnë. Rastet e abuzimit seksual të fëmijëve që bëhen publike janë të pakta në raport me rastet e paraportuara. Si pasojë e numrit të errët të këtyre rasteve, kryerësit do të mbeten të lirë duke viktimizuar fëmijë të tjerë, ndërsa fëmijët e viktimizuar do të jetojnë me traumën e shkaktuar, gjatë gjithë jetës. Si pasojë e mosraportimit po thuajse në çdo shtet ka mungesë të statistikave dhe të të dhënave të sakta. Shumë rrethana (p.sh kur kryerësi është mbajtës i familjes dhe ndëshkimi i tij do të rrezikonte ekzistencën e viktimës dhe familjes) detyrojnë si viktimën ashtu edhe familjen e saj, që mos ti paraqesin këto krime në polici dhe në organe tjera.<sup>3</sup>

Në një intervistë me themeluesin dhe drejtorin e Ambasadës së parë të fëmijëve Dragi Zmijanac në vitin 2008, ai tregoi për gjendjen momentale të abuzuesve seksual ndaj fëmijëve në RMV, shtetet Evropiane dhe shtetet tjera. Rreth një milion fëmijë në të gjithë botën janë viktima të ngacmimit seksual ndërsa të dhënat në të gjithë botën tregojnë se vetëm 30% e rasteve janë zbuluar. Sipas statistikave vajzat janë 5 herë më shumë viktima të abuzimit seksual sesa djemtë, d.m.th një në tre vajza dhe një në shtatë djem janë viktima të pedofilëve. Kur kryerësi është person i njohur për fëmijën, ato përpiqen të frikësojnë fëmijën duke kërcënuar dhe insistojnë që të jetë si "sekret i tyre".<sup>4</sup>

Frika nga hakmarrja e abuzuesit, lidhja familjare, mundësia e përjashtimit nga shoqëria, ndjenja e fajimit të vetes, manipulimi dhe kërcënimi nga ana e kryerësit, paaftësia mendore e viktimës, shpesh shfaqen si arsye të mos denoncimit të rasteve të keqpërdorimit seksual të fëmijëve. Mirëpo në shoqërinë e sotme moderne edhe pse të dhënat nga evidencat statistikore tregojnë se denoncimi i incidenteve të abuzimit të fëmijëve është në rritje në krahasim me të kaluarën (kohën kur çështja e abuzimit seksual të fëmijëve ishte tabu).

---

<sup>3</sup> Halili. R, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq 191

<sup>4</sup>Intervista e Dragi Zmijanac Ambasadës së parë të fëmijëve - MEGJASHI, [http://www.childrensambassy.org.mk/newsletter-34-ns\\_article-interview-dragi-zmijanac-ma-sc-executive-director-and-founder-of-the-first-children-s-embassy-in-the-nsp](http://www.childrensambassy.org.mk/newsletter-34-ns_article-interview-dragi-zmijanac-ma-sc-executive-director-and-founder-of-the-first-children-s-embassy-in-the-nsp)

Njerëzit që duan të abuzojnë fëmijët seksualisht mund t'u afrohen atyre në shumë lloj mënyra. Ata shpesh do të përfshijnë veten në aktivitete apo organizime që i sjellin ata në kontakt direkt me fëmijët.<sup>5</sup>

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH) Në vitin 2017, deri në 1 miliard të mitur prej moshës 2 deri 17 vjeç kanë përjetuar dhunë, qoftë fizike, emocionale, apo seksuale, përfshirë përkëdhelje dhe dhunime.<sup>6</sup> Po të njëjtin vit, UNICEF raportoi se, në 38 vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme, pothuajse 17 milion femra pranuan se kanë qenë viktimë e një marrëdhënie seksuale të detyruar gjatë fëmijërisë së tyre.<sup>7</sup>

Sipas OBSH në Evropë në vitin 2013 pothuajse 18 milion fëmijë kishin qenë viktimë të abuzimit seksual (13,4 përqind vajza dhe 5,7 përqind djem). Një raport i INTERPOL-it për 2017 mbi dhunën seksuale të të miturve kontriboi në identifikimin e 14,228 viktimave në 54 vende evropiane.<sup>8</sup>

Në Indi, janë raportuar gjithsej 48,338 raste të dhunimit të të miturve prej vitit 2001 deri në vitin 2011, me një rritje prej 336 përqind të numrit të raportuar nga 2001 (2,113 raste) në 2011 (7,112 raste).

Sipas të dhënave të qeverisë në Shtetet e Bashkuara, më shumë se 700 milion fëmijë janë viktimë të dhunës dhe abuzimit çdo vit.

Në Australi, në 2015-2017, një në gjashtë femra (16 përqind ose 1,5 milion) raportuan se kanë përjetuar abuzim fizik ose seksual para moshës 15 vjeç dhe një nga nëntë djem (11 përqind, ose 9,992,000) raportuan se ata u abuzuan kur ishin në moshë të mitur.

Sipas studimit në Afrikën e Jugut, në vitin 2016, një nga tre afrikano - jugorët kanë qenë të rrezikuar nga abuzimi seksual përpara se të arrinin moshën 17 vjeçe. Studimi në shkallë kombëtare tregoi se 784,967 adoleshentë midis moshës 15 dhe 17 vjeç kishin përjetuar abuzim seksual. Viktimat ishin kryesisht djem dhe më pak se një e treta kishin bërë raportime në polici.<sup>9</sup>

---

<sup>5</sup> Manuali – Kush abuzon!?

<https://www.keepingchildrensafe.org.uk/sites/default/files/KCS%20Tool%203%20Albanian.pdf>

<sup>6</sup> Violence against children, <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-children>

<sup>7</sup> Të dhëna në nivel global për abuzimin seksual të fëmijëve, <https://www.pbc2019.org/protection-of-minors/child-abuse-on-the-global-level>

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Magazine about Sexual Violence: Stopping Child Sexual Abuse, <https://www.policechiefmagazine.org/sexual-violence-stopping-child-sexual-abuse/>



Abuzimi seksual i fëmijëve nuk duhet të konsiderohet si një veprim, por si një proces. Përkundër asaj që keqbërësit zakonisht u thonë njerëzve kur përballen për herë të parë, abuzimi seksual i fëmijëve nuk është kurrë aksidental, i paplanifikuar ose i padëmshëm.<sup>10</sup>

## **2. Nocioni i abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë**

Abuzimi seksual ka të bëjë me sjellje seksuale që ushtrohen me forcë mbi fëmijën. Sjelljet seksuale mund të kenë natyrë të kontaktit fizik të padëshiruar, por mund të jenë ngacmime me fjalë, me sy, ekspozime të organeve gjinitale.<sup>11</sup> Çdo ekspozim i qëllimshëm i fëmijëve ndaj një aktiviteti seksual, ose përdorimi i fëmijëve për qëllime seksuale përbën abuzim seksual të fëmijës. Subjekt pasiv, viktimë e kësaj veprë penale është personi i gjinisë femërore apo mashkullore nën moshën 14 vjeçare, ndërsa kryerës është personi madhor, qoftë i gjinisë mashkullore apo femërore.<sup>12</sup> Në shumicën e rasteve, abuzuesi është dikush që fëmija e njeh, është dikush nga i cili fëmija varet fizikisht, emocionalisht apo financiarisht.<sup>13</sup> Në shumicën e shoqërive, abuzimi seksual i vajzave dhe djemve është më i përhapur brenda mureve të shtëpisë ku dhunimi është kryer nga një person i njohur të familjes. Dhuna seksuale gjithashtu ndodh në shkolla dhe mjedise të tjera arsimore, nga nxënësit e tjerë të klasës ose të shkollës ose dhe nga vetë mësuesit.<sup>14</sup>

Sipas disa autorëve “pedofilia” bën pjesë në grupin e termeve të “abuzimit seksual”, ndërsa abuzimi seksual është një nocion gjithpërfshirës i këtyre vepave. Edhe pse shpesh herë kanë veprën e njejtë motivin apo qëllimin këto dy terme dallojnë nga njëra-tjetra. Abuzuesit seksual ndaj fëmijëve nuk kanë ndonjë preferencë seksuale ndaj fëmijëve, por për arsye të ndryshme (stresi, depresioni, përdorimi alkoolit apo drogës, hakmarrja, arsye të tjera kriminale) ato veprojnë me fëmijë. Ndërsa pedofilët kanë çrregullim mental parafilik, fantazojnë dhe kanë preferencë seksuale ndaj fëmijëve.

---

<sup>10</sup> Brent E. Turvey, in Criminal Profiling (Fourth Edition), 2012,

<https://www.sciencedirect.com/topics/social-sciences/child-molestation>

<sup>11</sup> Haxhiymeri, E, Kullari, E, Hazizaj, A, “Abuzimi i fëmijëve në familje” Tiranë, 2005 fq.7

<sup>12</sup> I.Saliu, E drejta penale-pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009, fq.221

<sup>13</sup> Shehu, E & Gramo, A, Dhuna me bazë gjinore-Manual për punonjësit e mjeksisë, [http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania\\_Manual%20for%20health%20workers%20in%20Albanian.pdf](http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania_Manual%20for%20health%20workers%20in%20Albanian.pdf)

<sup>14</sup> Raport tematik: Dhuna tek fëmijët vajza, Lidhja kombëtare e ndihmës për fëmijët, Tiranë, 2013

Sipas Manualit Diagnostik dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore nga Asociacioni Psikiatrik Amerikan, pedofil është një individ që fantazon, nxitet seksualisht ose përjeton nxitje seksuale ndaj fëmijëve adoleshentë (më të rinj se 13 vjeç) për një periudhë prej së paku 6 muaj. Pedofilia klasifikohet si parafili, një nga çrregullimet psiko-seksuale. Disa nga çrregullimet parafilike janë: vojerizmi, ekspozimi, pedofilia, fetishizmi, sadizmi, etj.<sup>15</sup>

Duke pasur parasysh veprën e rëndë që i paraprijnë këtyre nocioneve, shumica e autorëve rekomandojnë që në vend të termit “pedofili” (që përdoret në shkencat psikologjike dhe psikiatrike) të përdoren termet si: keqpërdorim seksual i fëmijëve, ngacmim seksual i fëmijëve, malltretim seksual ndaj fëmijëve, etj.

Pedofilia është e njohur si çrregullim. Për t’u diagnostikuar si “pedofil”, një person duhet:

- të ketë tërheqje seksuale, fantazi ose imagjinatë seksuale për të miturit si dhe kontakt seksual me to (më së paku 6 muaj);
- të jetë së paku 16 vjeç,
- të jetë së paku 5 vite më i vjetër se viktimi.<sup>16</sup>

Është e rëndësishme të specifikojmë disa faktorë që ndryshojnë te abuzimet seksuale dhe duhet ti kemi parasysh gjatë rasteve të studimit apo të dhënave nga hulumtimet. Këtu bëjnë pjesë: lloji i aktit seksual, natyra e marrëdhënies ndërmjet pjesmarrësve, kohëzgjatja e abuzimit, shkalla e dhunës dhe kërcënimit, moshë dhe niveli i zhvillimit të pjesëmarrësve, konteksti familjar dhe kulturor në të cilin kanë ndodhur veprimet.<sup>17</sup>

Fëmijët të cilët janë më shumë të rrezikuar nga abuzimi seksual, janë:

- fëmijët, prindërit e të cilëve janë të ndarë apo njëri nga prindërit ka ndëruar jetë,
- fëmijët që jetojnë me njerë apo fëmijët e adoptuar,
- fëmijët, prindërit e të cilëve kanë probleme shëndetësore (fizike apo psiqike),
- fëmijët, prindërit e të cilëve janë të ndikuar nga alkooli apo substancat narkotike, etj.

---

<sup>15</sup> Të dhëna nga Manualit Diagnostik dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore nga Asociacioni Psikiatrik Amerikan (DSM-5), <https://www.psychiatry.org/psychiatrists/practice/dsm>

<sup>16</sup> An Ongoing Sex Drive Directed Toward Children, [http://www.childmolestationprevention.org/pages/focus\\_on\\_the\\_cause.html](http://www.childmolestationprevention.org/pages/focus_on_the_cause.html)

<sup>17</sup> MacFarlane. K, et. al., Sexual abuse of young children, New York, 1987.

## 2.1 Karakteristikat e kryerësve

Abuzimi seksual i fëmijëve nuk është momental, i pa planifikuar dhe i paparashikuar. Për shumicën kryerësi është i njohur për fëmijën. Kryerës zakonisht janë personat e besuar të rrethit familjar apo personat të cilët drejtpërdrejtë kanë qasje me jetën e fëmijëve.<sup>18</sup> Kryerësit mund të jenë të moshuar apo të rinj, të pasur apo të varfër, të arsimuar ose të paarsimuar, jo profesional ose profesional dhe të çdo race. Është e pamundur për të përshkruar një keqtrajtues tipik seksual të fëmijëve. Ata vijnë nga të gjitha mjediset shoqërore dhe etnike dhe mund të gjenden në të gjitha profesionet në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe nganjëherë gëzojnë pozita të respektuara dhe të fuqishme në komunitet duke përfshirë edhe ato fetare.<sup>19</sup>

Abuzuesit punojnë për të zotëruar aftësitë e tyre manipuluese duke u bërë së pari mik i të miturit, duke krijuar besim tek ato. Ata nuk duken ndryshe nga njerëzit e tjerë apo sillen në mënyra të ndryshme. Është e mundur që çdo person më i fuqishëm se fëmija të jetë malltretues potencial i tij. Kështu në kategorinë e abuzuesve potencial të fëmijëve mund të përshihet një bashkëmoshatar më i fuqishëm, një i rritur, prindi, kujdestari, edukatori, etj.<sup>20</sup>

Sipas hulumtimit “Të braktisur dhe të damkosur” të vitit 2010 shumica e autorëve të krimit (93%) ishin meshkuj. Në rastet kur për këtë veprë janë akuzuar femrat, ato femra më rrallë janë akuzuar si autore të drejtpërdrejta të krimit dhe shumë më shpesh si bashkëpjesëmarrëse ose ndihmëse të meshkujve, më shpesh në rastet e jetës jashtëmartesore me të mitur. Shumica e autorëve të krimit (32%) kur e kanë kryer veprën penale kanë qenë të moshës 18 - 24 vjeç. Megjithatë, 27% e tyre kanë qenë në moshën 31-40 vjeç, ndërsa 30% e tyre kur e kanë kryer veprën penale kanë qenë të moshës 40 vjeç. Në raport me autorët e krimit që kanë qenë në moshë më të re, 9 prej tyre edhe vetë kanë qenë të moshës nën 18 vjeç.

Përbërja etnike e personave të dënuar për abuzim seksual të fëmijëve dëshmon se ata mund të jenë nga të gjitha bashkësitë etnike të cilat jetojnë në vend. Karakteristikë që vihej re ishte niveli relativisht i ulët i autorëve të krimit: 20% e tyre pohonin se nuk kanë kurrfarë arsimimi dhe andaj janë analfabetë, ndërsa 52% e tyre kishin të mbaruar vetëm shkollë fillore.

<sup>18</sup> Sgroi, Suzanne M., Handbook of clinical intervention in child sexual abuse, Canada, 1989.

<sup>19</sup> Manuali – Kush abuzon!?,

<https://www.keepingchildrensafe.org.uk/sites/default/files/KCS%20Tool%203%20Albanian.pdf>

<sup>20</sup> Murtezani.L, Keqpërdorimi i fëmijëve në kulturat e ndryshmeve, Tetovë, 2009, fq.48

Thujse gjysma e autorëve të krimit (45%) janë të martuar, kanë qenë të martuar ose kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore. Të dhënat e disponueshme po ashtu flasin se së paku gjysma e autorëve të krimit kanë qenë prindër të një ose dy fëmijëve. Shumica e personave që janë gjykuar për abuzim seksual të fëmijëve (83%) këtë vepër e kanë bërë për herë të parë.<sup>21</sup>

Dr.Park Elliot Dietz grupon abuzuesit seksual në dy kategori: abuzues seksual të situatës dhe abuzues seksual preferencial.

**Abuzues seksual të situatës** - Në këtë grup abuzuesit nuk kanë preferencë seksuale ndaj fëmijëve, si dhe vperimi seksual mund të ndodh vetëm një herë. Shpesh ky lloj abuzimi ndodh nga stresi apo ngarkesa momentale. Motivi kryesor i tyre është eksperimentimi seksual, ndërsa viktimat të disponueshme janë fëmijët e tyre.

**Abuzues seksual preferencial** - Ky grup abuzuesish i kanë qart të definuar preferencat e tyre seksuale. Imagjinata dhe fantazia e tyre është e fokusuar kah fëmijët. Ato nuk abuzojnë për shkak të stresit momental apo pasigurisë, ato seksualisht janë të dhënë pas fëmijëve dhe preferojnë ato (pedofilia). Zakonisht kanë preferenca të ndryshme, duke pasur parasysh moshën dhe gjininë.<sup>22</sup>

Ndërsa sipas Edmond Dragotit njihen dy kategori të abuzuesve seksual të fëmijëve: abuzuesit fiksiv që kanë si objekt parësor një fëmijë dhe si partnerë seksual parapëlqejnë më tepër fëmijët se sa të rriturit dhe abuzues regresiv, që zakonisht interesin seksual e kanë ndaj një të rrituri, por nga stresi i madh (vështirësi martesore, humbje të punës, vdekje në familje) ai regresohet emocionalisht (psikologjisht bëhet më i ri) dhe vepron me fëmijë për të plotësuar nevojat e veta.<sup>23</sup>

### 3. Abuzimi seksual i fëmijëve dhe pedofilia në RMV

Fenomeni i abuzimit seksual të fëmijëve në vendin tonë është më se serioz. Rastet e abuzimit të fëmijëve janë bërë incidente të përditshme. Fëmijët rrihen, keqpërdoren dhe abuzohen. Subjekt pasiv, viktimë e kësaj veprë penale është personi i gjinisë femërore apo mashkullore nën moshën 14 vjeçare, ndërsa kryerës është personi madhor, qoftë i gjinisë

<sup>21</sup> Çaçeva, V. & Mirceva, S. Të braktisur e të damkosur: Analiza e gjendjes: Abuzimi seksual i fëmijëve, 2010, Shkup: Zyra e UNICEFit.

<sup>22</sup> National Center for Missing & Exploited Children, 1992, Child Molesters: A Behavioral Analysis, fq.5-9, <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/Digitization/149252NCJRS.pdf>

<sup>23</sup> Dragoti. E, Hyrje në punë sociale, Tiranë, 2009, fq.195

mashkullore apo femërore.<sup>24</sup> Format e ndryshme të dhunës seksuale ndaj fëmijëve, si dhe ndaj të miturve që nuk kanë mbushur 14 vjeç, rregullohen me Kodin Penal të RMV-së. Ndërsa me Ligjin për drejtësi për fëmijë (Gazeta Zyrtare nr.148/2013) rregullohen masat për mbrojtjen e fëmijëve viktime të veprave, që me ligj janë paraparë si vepra penale.

Termi abuzim seksual i fëmijëve është term legal, juridik i përdorur gjërësisht në legjislacionet penale të shteteve të ndryshme, ndërkaq me termin pedofili më shumë shërbehen shkencat psikologjike dhe psikiatrike. Dallimi midis pedofilisë dhe abuzimit seksual të fëmijës është qenësor për trajtimin mjekësor të këtyre individëve.<sup>25</sup> Sipas Kodit Penal të RMV-së (neni 188 – Sulmi seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet) ai i cili do të kryejë akt seksual ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet, do të dënohet me së paku 12 vjet burg.<sup>26</sup>

Një nga hulumtimet e pakta në vendin tonë është hulumtimi i lartpërmendur “Të braktisur e të damkosur”, i financuar nga UNICEFi në vitin 2010 ndërsa është përgatitur nga Instituti i Studimeve Sociologjike, Politike dhe Juridike të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.<sup>27</sup> Dy qëllimet specifike të hulumtimit ishin:

- Të identifikohej politikat vijuese të praktikave të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në vendin tonë në raport me abuzimin seksual të fëmijëve; dhe
- Të bëhet vlerësimi i kapaciteteve institucionale aktuale që fëmijët të mbrohen nga abuzimi seksual.

Të dhënat që janë analizuar dhe janë paraqitur këtu janë marrë nga tre burime kryesore:

- 105 dosje për fëmijët që kanë qenë viktime të abuzimit seksual nga qendrat e punës sociale nëpër gjithë vendin për periudhën janar 2004 – qershor 2009.
- Vendimet gjyqësore për 231 persona të akuzuar për abuzim seksual të fëmijëve, të gjykuar në gjykatat themelore në gjithë vendin në periudhën janar 2004 – qershor 2009.
- 25 fokus-grupe me pjesëmarrës të institucioneve konkrete, të përbëra nga 247 profesionistë të shkollave fillore, të kopshteve të fëmijëve, të qendrave të punës sociale, të

---

<sup>24</sup> Saliu, I., E drejta penale-pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009, fq.221

<sup>25</sup> Ratkoceri, V, Kastrimi kimik si sanksion penal, fq.11, 2018

<sup>26</sup> Osmani A., Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 188, Shkup, 2015 përkthyer në gj.shqipe

<sup>27</sup> Çaçeva, V. & Mirceva, S. Të braktisur e të damkosur: Analiza e gjendjes: Abuzimi seksual i fëmijëve, 2010, Shkup: Zyra e UNICEFit.

policisë dhe të sektorit të shëndetësisë. Diskutimet me fokus-grupe u zhvilluan në periudhën shtator-nëntor 2009.<sup>28</sup>

Analizat që janë bërë në këtë studim tregojnë se shumica e fëmijëve që janë abuzuar seksualisht janë vajza. Në ekzemplarin e QPS-ve vërehet se në 78% të rasteve ato viktime kanë qenë vajza, ndërsa po ashtu 90% e vendimeve gjyqësore kanë përfshirë vajza. Dosjet e QPS-ve flasin se fëmijët e regjistruar të gjinisë femërore janë viktime të më shumë tipave të abuzimit seksual në krahasim me fëmijët e gjinisë mashkullore.

Mosha e fëmijëve të abuzuar seksualisht, të përfshirë me këtë studim, është ndërmjet 4 dhe 18 vjeç. Edhe në dosjet e QPS-ve dhe në vendimet gjyqësore shihet se shumica e rasteve janë fëmijë të moshës 10-13 vjeç: në 52% të rasteve në QPS dhe në 47% të vendimeve gjyqësore.<sup>29</sup>

Avokati i popullit të RMV në vitin 2012 publikoi “Raportin nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve”. Qëllimi i hulumtimit ishte grumbullimi i të dhënave nga të gjitha organet dhe institucionet relevante me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike me abuzimin seksual dhe eksploatimin seksual të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë. Hulumtimi është kryer në mbarë Republikën e Maqedonisë dhe është bazuar mbi të dhënat, masat dhe rekomandimet e të gjitha organeve kompetente (të gjitha gjykatat kompetente, prokuroritë publike, qendrat për punë sociale, organet policore dhe organizatat joqeveritare).<sup>30</sup>

Sipas **Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë** gjykata mundet, kryerësit të cilit i ka shqiptuar dënim me burgim ose dënim me kusht, me të cilin është përcaktuar dënimi me burgim, t’ia ndalojë ushtrimin e profesionit ose veprimtarinë e caktuar ose detyrën apo punën që ka të bëjë me veprën penale. Kohëzgjatja e ndalimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit e as më e gjatë se dhjetë vjet. Kështu, për vepër penale “Sulm seksual mbi fëmijë” parashikohet që nëse veprimi seksual mbi të miturin, i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, është kryer nga farefisi ose vëllai, përkatësisht motra, mësimdhënësi, edukatori, adoptuesi,

---

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Avokati i Popullit, Raport nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, 2012, Shkup

kujdestari, mjeku ose person tjetër me keqpërdorimin e pozitës së tij, përveç dënimit me burgim i shqiptohet edhe ndalimi për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Gjithashtu, ndalimi i këtillë është paraparë edhe për kryerësin e veprës penale “Akt seksual me keqpërdorim të pozitës”.<sup>31</sup>

Në vitin 2018 Enti shtetëror i statistikës publikoi të dhëna statistikore për kryerësit e denoncuar, akuzuar dhe të gjykuar të vitit 2017, për veprën penale të abuzimit seksual të fëmijëve. Këto të dhëna janë rezultat i hulumtimeve statistikore të rregullta dhe sigurojnë informata për kryerësit e veprave penale në të gjitha fazat procedurale, duke filluar nga dorëzimi i fletëparaqitjes e deri te aktvendimi i plotëfuqishëm.<sup>32</sup>

Në vijim përmes tabelës do të paraqesim të dhëna statistikore të siguruara nga ky raport për kryerësit e veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, gjatë vitit 2017.

**Tabela 1:** Kryerësit e veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor ndaj fëmijëve në vitin 2017

Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	Persona të denoncuar	Persona të akuzuar	Persona të gjykuar	Të burgosur	Masa alternative	Dënim me gjobë
Gjithësej	64	45	38	28	9	1
Dhunim	29	13	13	11	2	-
Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet	17	12	9	8	1	-
Të tjera	18	20	16	9	6	1

Nga të dhënat statistikore të paraqitura më lartë vërejmë që numri rasteve të denoncuar për tërë vitin 2017 në RMV është 64, 29 prej të cilëve kanë denoncuar dhunë, 17 sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet dhe 18 tjerë. Këto shifra në fakt na tregojnë një pjesë të vogël të asaj se ç’ndodh në realitet, pjesa tjetër mbetet e pa zbuluar për arsye të ndryshme.

Sipas Entit shtetëror të statistikës në vitin 2017 nga vepra e sulmit seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet është gjykuar një fëmijë i moshës 14-16 vjeç, ndaj të cilit është

<sup>31</sup> Avokati i Popullit, Raport nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, 2012, Shkup.

<sup>32</sup> Kryerësit e veprave penale në vitin 2017, Entit shtetëror të statistikës, [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)

shqiptuar masa e mbikqyrjes së përforcuar, si dhe një fëmijë i moshës 16-18 vjeç me masë të njëjtë të dënimit.

#### **4. Masat parandaluese të abuzimit seksual dhe pedofilisë**

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për t'u mbrojtur kundrejt të gjitha formave të dhunës fizike ose mendore, lëndimeve apo abuzimit, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, keqtrajtimit ose shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual, ndërsa ndodhen nën kujdesin e prindit/prindërve, kujdestarit/kujdestarëve ligjorë ose ndonjë personi tjetër i cili ka në kujdes fëmijën.<sup>33</sup> Çdo shtet dhe çdo institucion duhet të krijojë mekanizma për të siguruar që fëmijët nuk dëmtohen apo abuzohen dhe të sigurohet që të gjitha shqetësimet ndaj abuzimit të fëmijëve të raportohen dhe të trajtohen nga autoritetet. Fëmijët kërkojnë gjithnjë mbrojtje të veçantë si në sipërfaqen private të shtëpisë deri tek hapësirat publike të shkollës. Përgjegjësia kryesore për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi në rradhë të parë u takon prindërve, si dhe çdo profesionisti që ka lidhshmëri me jetën e një fëmije: mësues, mjek, polic, punonjës social, psikolog dhe shumë të tjerë që duhet të raportojnë dhe të ndjekin çdo shenjë të abuzimit të fëmijëve.

Një i rritur i mbijetuar nga abuzimi seksual në fëmijëri mund të jetë një ndihmës i përkryer në të ndihmuarit e të tjerëve që janë në ankth. Shumë praktikantë profesionist për të ndihmuar janë vet viktima të fshehur edhe nga vetja e tyre. Disa do të jenë të paafte të kenë ndjeshmëri me fëmijët e abuzuar. Të tjerët më tej gjatë rimëkëmbjes së tyre të pjesshme nga abuzimi, mund të ndjejnë keqardhje vetëm për fëmijët dhe të jenë kundër abuzuesve.<sup>34</sup>

Pjesën më të madhe të shekullit të 20-të, dhuna ndaj fëmijëve, aq më pak dhuna seksuale nuk ishte përparësi për avokatët ndërkombëtarë të zhvillimit ekonomik dhe social. Kjo ndryshoi kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Konventën për të Drejtat e Fëmijëve në 1989, duke krijuar një imperativ ligjor për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha manifestimet e dhunës, përfshirë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve.<sup>35</sup>

Konventa është një ndër instrumentet më të pranuar, në nivel botëror, i të drejtave të njeriut në histori. Ajo është ratifikuar nga çdo vend në botë, përveç dy vendeve dhe i vendos

<sup>33</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, neni 19

<sup>34</sup> MacFarlane, K, et. al., Sexual abuse of young children, New York, 1987.

<sup>35</sup> The Economist Intelligence Unit Limited 2019, Out of the shadows: Shining light on the response to child sexual abuse and exploitation, supported by World Childhood Foundation and the Oak Foundation, <https://outoftheshadows.eiu.com/wp-content/uploads/2019/01/Out-the-Shadows-Whitepaper.pdf>



fëmijët në qendër të vizioneve zhvillimore ndërkombëtare. Me ratifikimin e këtij traktati, qeveritë kombëtare janë angazhuar për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të fëmijëve dhe kanë rënë dakord për të mbajtur përgjegjësi para bashkësisë ndërkombëtare për këtë angazhim. Konventa përqëndrohet në mbrojtjen dhe garantimin e disa të drejtave thelbësore të fëmijëve, si:

- e drejta e mbijetesës;
- e drejta për zhvillim sa më të plotë;
- e drejta për mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme, abuzimi dhe shfrytëzimi;
- e drejta për të marrë plotësisht pjesë në jetën familjare, kulturore dhe sociale.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual” e njohur si “Konventa e Lanzarotes” u miratua në vitin 2007 në Lanzarote, Spanjë.

Për shkak të dëmit të konsiderueshëm në zhvillimin e fëmijës Konventa kriminalizon të gjithë veprat seksuale ndaj fëmijëve.<sup>36</sup> Konventa pikë fokusi ka respektimin e të drejtave të fëmijëve, duke siguruar mirëqenien e tyre, duke iu përgjigjur pikëpamjeve, nevojave dhe shqetësimeve të tyre dhe duke vepruar gjatë të gjithë kohës në interesin më të mirë të fëmijëve. Në Konventë janë të përfshira disa nene që kanë të bëjnë me masat parandaluese, masat mbrojtëse, masat ndihmëse të abuzimit seksual të fëmijëve. Si fillim kemi nenin e katërt ku thuhet: “Çdo palë merr masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për parandalimin e të gjitha formave të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për mbrojtjen e fëmijëve”.<sup>37</sup>

Në SHBA shumica e shkollave fillore kanë program edukativ-arsimor për njohjen e abuzimit seksual të fëmijëve, si të shmangim këto aktivitete dhe si të përballemi me to. Ky lloj programi përfshin lojëra, filma, aktivitete dhe ushtrime praktike nëpërmjet të cilave fëmijët do të njoftohen me dukurinë e abuzimit seksual.<sup>38</sup>

Kastrimi kimik është një tretman i domosdoshëm dhe human për trajtimin e një kategorie të caktuar të abuzuesve seksual të fëmijëve (pedofilëve) dhe që nëse zbatohet në mënyrë

---

<sup>36</sup> Konventa e Lanzarotes, <https://www.coe.int/en/web/children/lanzarote-convention>

<sup>37</sup> Po aty, neni 4

<sup>38</sup> Vandenhoeck & Ruprecht, Werner Hilweg/Elisabeth Ullmann (Hg): Kindheit und Trauma, Göttingen, 1997, 1999

adekuate konform disa rregullave bazë, kontribon në parandalimin e këtyre abuzuesve për të përsëritur veprën penale. Kastrimi kimik është terapi hormonale e cila e ul epshin seksual të kryerësit. Kastrimi kimik si dënim në legjislacionet e shteteve të ndryshme është paraparë për veprat penale kryesisht të rënda të abuzimit seksual.<sup>39</sup>

Në vitin 2016, dhjetë agjenci bashkëpunuan për të zhvilluar INSPIRE, një paketë teknike me shtatë strategji kryesore për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve. INSPIRE është një bashkëpunim midis organizatave të iniciuara nga Organizata Botërore e Shëndetit. Organizatat bashkëpunuese janë: Qendrat e Shteteve të Bashkuara për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC), Fund dhunës ndaj Fëmijëve, Organizata Pan Amerikane e Shëndetit (PAHO), Programi i Urgjencës së Presidentit për Ndhmën e AIDS (PEPFAR), Së bashku për Vajzat, Kombet e Bashkuara Fondi i Fëmijëve (UNICEF), Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Banka Botërore. 7 strategjitë kyçe që përbëjnë fjalën INSPIRE janë: Implementimi dhe Zbatimi i Ligjit; Normat dhe vlerat; Mjedise të sigurta; Ndhma për prindërit dhe kujdestarët; Të ardhurat dhe forcimi ekonomik; Shërbime të Reagimit dhe Mbështetjes; Arsimi dhe Aftësitë e Jetës.<sup>40</sup> Këto 7 tema kanë nga një shkronjë të parë që përbëjnë fjalën INSPIRE (inspirim), e cila u ofron shteteve dhe organizatave joqeveritare mekanizma që të intervenojnë në reduktimin e dhunës ndaj fëmijëve.

ECPAT është një rrjet global i organizatave dhe individëve (përfshirë 50 shtete) që punojnë së bashku për eleminimin prostitucionit të fëmijës, pornografisë për fëmijë dhe trafikimin e fëmijëve për qëllime seksuale.<sup>41</sup> ECPAT me seli në Bankok përfshin rreth 44 ogranizata nga e gjithë bota. Në të gjitha fushatat e ECPAT për një mbrojtje më të mirë të fëmijëve, temë e përsëritur ka qenë domosdoshmëria që vendet e zhvilluara të marrin përgjegjësi për veprimet e shtetasve të tyre jashtë vendit. Si rezultat i kësaj disa shtete kanë ndryshuar ligjet e tyre, në

---

<sup>39</sup> Ratkoceri.V, Kastrimi kimik si sanksion penal, 2018

<sup>40</sup> United Nations Children's Fund, INSPIRE Indicator Guidance and Results Framework - Ending Violence Against Children: How to define and measure change, UNICEF, New York, 2018

<sup>41</sup> Organizatat për eleminimin prostitucionit të fëmijës, pornografisë për fëmijë dhe trafikim i fëmijë për qëllime seksuale, ballina e faqes [www.ecpat.org](http://www.ecpat.org)

bazë të së cilave do të mund t'i ndjekin penalisht shtetasit e vet për veprat e kryera në vend të huaj.<sup>42</sup>

Fëmijët gëzojnë një mbrojtje të posaçme si dhe meritojnë kushte të volitshme për të siguruar mirëqenien e tyre dhe harmoni për sa i takon zhvillimit fizik-shëndetësor, psikologjik dhe social. Të gjithë shtetet duhet të ndërmarrin të gjitha masat preventive dhe represive me qëllim që në mënyrë sa më efektive të luftojnë dhe parandalojnë të gjithë veprat penale që kanë të bëjnë me abuzimin seksual të fëmijëve.

#### 4.1 Masat parandaluese në RMV

Shoqëria duhet të njihet me të drejtat e fëmijëve dhe instrumentet ndërkombëtare që ka nënshkruar shteti ynë në mbrojtje të tyre sepse në to është marrë në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës. Nevoja për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve buron nga fakti se ata paraqesin një grup shoqëror shumë të ndjeshëm që shumë lehtë mund jetë pre e keqtrajtimit dhe dhunës.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriore në nenin 11 rregullon paprekshmërinë e integritetit fizik dhe moral të njeriut, ndalon të gjitha format e torturës, trajtimin apo dënimin çnjerëzor ose degradues, ndërsa në nenin 42 specifikon mbrojtjen e veçantë të amësisë, fëmijëve dhe të miturve.<sup>43</sup>

Për shkak të mbrojtjes preventive të fëmijëve, të cilët janë në rrezik për t'u bërë viktimë ose kryerës të veprave penale, po edhe viktimë të abuzimit seksual, me **Ligjin për të drejtat e të miturve** janë paraparë më tepër masa për ndihmë dhe mbrojtje, ndërkaq edhe mekanizma të cilët duhet të kontribuojnë për veprim parandalues, siç është formimi i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve.<sup>44</sup> Njëkohësisht vlen të përmendet neni 137 i **Ligjit për të drejtat e të miturve**,<sup>45</sup> ku theksohet se në procedurën penale ku si viktimë kemi të miturin, gjykatat, prokuroritë publike dhe personat zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të veprojnë vetëm nëse posedojnë arsimim përkatës, njohuri të veçanta dhe përvojë nga fusha e drejtësisë për fëmijë dhe për mbrojtjen penale-juridike të të miturve.

<sup>42</sup> Seabrook. J, No hiding place: Child Sex Tourism and the Role of Extraterritorial Legislation, 2000

<sup>43</sup> Kushtetuta e RMV-së, Gazeta Zyrtare nr.08-4642/1, Shkup, 17 nëntor 1991, neni 11

<sup>44</sup> Avokati i Popullit, Raport nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, 2012, Shkup

<sup>45</sup> Ligji për të drejtat e miturve, Gazeta Zyrtare, nr.87/2007, 145/2010, neni 137

RMV gjithashtu ka miratuar **Ligjin për drejtësi të fëmijëve**<sup>46</sup>, në vitin 2013 (Gazeta Zyrtare, nr.148/13).

Sipas nenit 145 të këtij ligji: Fëmija viktimë e veprës penale i ka të drejtat në vijim:

- me të të veprohet me respektimin e dinjitetit e tij,
- të mbrohet nga çfarëdo diskriminimi,
- të njoftohet për të drejtat e tij në gjuhë të kuptueshme dhe të përshtatshme për moshën e tij, si dhe respektimin e të drejtës së privatësisë,
- të informohet prindi/ët, ose tutori/ët për të gjitha çështjet që lidhen me veprën penale dhe në lidhje me të dyshuarin, të akuzuarin dhe të dënuarin,
- fëmija, ose prindi/ët, ose tutori/ët të marrin pjesë në procedurën penale si i dëmtuar me përfshirje në ndjekjen penale ose për realizimin e kërkesës juridike pronësore për dëmin,
- në mbrojtje të veçantë të sigurisë së tij dhe të sigurisë së familjes së tij, kujdesit dhe vëmendjes nga ana e organeve dhe subjekteve që marrin pjesë në procedurën penale,
- të drejtë për mbrojtje të veçantë nga viktimizimi sekondar dhe riviktimizimi dhe
- të drejta për ndihmë psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga organe, institucione dhe organizata për ndihmë fëmijëve viktimë të veprave penale.<sup>47</sup>

Mbrojtja penale e fëmijëve-viktima të abuzimit seksual është në pajtim me Kodin Penal dhe Ligjin e Procedurës Penale. Nenet që rregullojnë procedurën e identifikimit, zbulimit, ndjekjes penale, mbledhjes së provave dhe vendosjen e tyre para gjykatës, si dhe shqiptimin e sanksioneve, përfshihen në Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për të drejtat e të miturve.<sup>48</sup>

Shteti ynë ka ndërmarrë disa masa në lidhje me parandalimin e kësaj dukurie si dhe masa ndihmëse të personave veç më viktimë të abuzimit seksual, si: plan veprime, programe, protokolle, standarde dhe norma për parandalim, mbrojtje dhe trajtim të fëmijëve viktimë të abuzimit, ka miratuar ligje të ndryshme dhe konventa që kanë të bëjnë me këtë temë.

Në vijim do të analizojmë disa nga këto masa të ndërmarra nga institucionet shtetërore në këtë drejtim, siç janë:

---

<sup>46</sup> Ligji për drejtësi të fëmijëve, Gazeta Zyrtare, nr.148/13

<sup>47</sup> Ligji për drejtësi të fëmijëve, Gazeta Zyrtare, nr.148/13, neni 145

<sup>48</sup> Mr.Popeski.S, Të miturit viktimë të veprave penale si kategori e marginalizuar në shoqërinë tonë

- Plani aksional për parandalimin dhe menaxhimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë 2009-2012”,

- Ligji mbi regjistrin për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV,

- Protokollin për bashkëpunim ndërmjet organeve kompetente në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë,

- Trajtimi mjekësor farmakologjik si masë sigurie për abuzuesit seksualë të fëmijëve ose e njohur ndryshe si “kasttrim kimik i pedofilëve”.<sup>49</sup>

**Plani aksional për parandalimin dhe menaxhimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë 2009 – 2012** synon të sigurojë mjete dhe mekanizma për zbatimin e ndihmës dhe mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi seksual dhe pedofilia si dhe krijimin e një sistemi të koordinuar të bashkëpunimit midis institucioneve qeveritare dhe midis sektorëve qeveritar dhe joqeveritar, duke mbuluar të gjitha fushat e përfshira në këtë çështje. Plani aksional për parandalimin dhe menaxhimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë 2009-2012 do të kontribuojë në zvoglimin dhe trajtimin e pasojave të kësaj dukurie duke rritur ndërgjegjësimin, duke marrë masa parandaluese, duke siguruar mbrojtje të koordinuar dhe efektive, ndihmë, rehabilitim dhe riintegrim të fëmijëve viktime të abuzimit seksual.<sup>50</sup>

Në muajin janar të vitit 2012, u miratua **Ligji për regjistrin e veçantë të personave të dënuar për vepra penale për abuzim seksual të personave të mitur dhe pedofili**.<sup>51</sup> Qëllimi i Ligjit dhe zbatimi i tij është sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi seksual dhe pedofilia përmes arritshmërisë së informatave për personat të cilët jetojnë në rrethin e tyre, ndërkaq të cilët janë dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me abuzimin seksual të personave të mitur dhe pedofili.

**Protokollin për bashkëpunim ndërmjet organeve kompetente në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë.** Me këtë Protokoll rregullohet bashkëpunimi i organeve kompetente

---

<sup>49</sup> Ratkoceri.V, Criminal policy of Republic of Macedonia for combating and preventing sexual abuse of children. Proceedings of the 11th South East European Doctoral Student Conference, 2017

<sup>50</sup> Plani aksional për parandalimin dhe menaxhimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë 2009 – 2012, [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>51</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrin e veçantë për personat e dënuar për vepra penale për abuzim seksual të të miturve dhe pedofilisë, Gazeta Zyrtare, nr.112 / 2014

në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Abuzimit Seksual të Fëmijëve dhe Pedofilisë për vitet 2009-2012, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Në Protokoll janë përfshirë format, mënyra dhe përmbajtja e bashkëpunimit ndërmjet organeve kompetente dhe pjesëmarrësve tjerë në zbulimin dhe parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë në dhënien e mbrojtjes së fëmijëve-viktima të abuzimit seksual dhe pedofilisë, si dhe ndryshimin e sjelljes dhe integrimin e në shoqëri të kryerësve të veprave të këtilla.<sup>52</sup>

Shumë shtete kanë inkorporuar në legjislacionin e tyre tretman mjekësor **farmakologjik-kastrimin kimik**, si masë të domosdoshme për parandalimin e recidivizmit të pedofilëve dhe mbrojtjen e fëmijëve. Edhe RMV duke u udhëhequr nga ky parim, me ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2014, u bë shteti i parë në rajon e cila e inkorporoi në legjislacionin e saj penal kastrimin kimik si masë të sigurisë për abuzuesit seksual të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare.<sup>53</sup>

**Kodi Penal** i Republikës së Maqedonisë Veriore përmban një kapitull të veçantë të krimeve kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual që kriminalizon veprat e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë. Në këtë kapitull dënohen veprimet e dhunimit të fëmijëve apo ndonjë veprim tjetër seksual mbi fëmijën me keqpërdorimin e zhvillimit të tij psikik, braktisja e fëmijës të paaftë si dhe tregtia me person të mitur. Veprime të numërta të kryera me persona të mitur apo të pafuqishëm janë formë kualifikuese e veprave penale, të sanksionuara me dispozitat e KP.

**Konventa për të drejtat e fëmijëve**<sup>54</sup> u nënshkrua edhe nga RMV në vitin 1993, më vonë edhe dy protokollat fakultative: Protokollin fakultativ për tregtinë me fëmijë, prostitucion me fëmijë dhe pornografia fëmijërore, e ratifikuar në vitin 2003 dhe Protokollin fakultativ i Konventës për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, e ratifikuar në vitin 2004. Sipas kësaj Konvente, shtetet palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, shtetet palë marrin në mënyrë të

---

<sup>52</sup> Avokati i Popullit, Raport nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, Shkup, 2012

<sup>53</sup> Ratkoceri. V, Kastrimi kimik si sanksion penal, 2018

<sup>54</sup> Konventa për të drejtat e fëmijëve, 1989, <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

- (1) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;
- (2) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;
- (3) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike. (neni 34).

Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të fëmijëve, veçanërisht kur bëhet fjalë për fëmijë viktimë të abuzimit seksual, institucionet shtetërore duhet të kujdesen dhe të veprojnë në atë mënyrë në të cilën fëmijët viktimë të mos përjetojnë traumën për herë të dytë. Kështu duhet të veprohet edhe me fëmijët dëshmitar të një ngjarje të tillë apo prezent në ndonjë lloji tjetër të abuzimit. Si një ndër masat preventive që do të ndihmonte sistemin tonë në luftën kundër abuzimit seksual të fëmijëve është edhe informimi dhe edukimi i fëmijëve, duke filluar që nga moshën më të hershme përmes programeve arsimore, edukimin e prindërve dhe personave profesionistë, si dhe përfaqësuesve të mediave për rreziqet e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve.

"Mos u frikësoni nga ajo, ngrisni zërin rreth problemit të abuzimit të fëmijëve, pasi vetë fëmijët nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë"- <sup>55</sup> tha Lynne Montgomery në një mbledhje dhe debat mbi problemin e abuzimit, të mbajtur në Fakultetin Juridik të Rijekës, në fillim të vitit 2000.

Ambasada e parë për fëmijë në botë MEGJASHI<sup>56</sup> është organizata më e vjetër qytetare në Republikën e Maqedonisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, e themeluar më 29 Prill 1992 nga Gordana Pirkovska Zmijanac dhe Dragi Zmijanac. Megjashi me aktivitetet e veta ka kontribuar në zhvillimin dhe forcimin e vetëdijes qytetare për të drejtat e fëmijëve. Ajo e rrëzoi heshtjen për vuajtjet e fëmijëve, posaçërisht për keqpërdorimet fizike, seksuale dhe ekonomike të fëmijëve, duke i zbuluar opinionit më shumë raste të keqpërdimeve dhe duke u angazhuar drejtpërdrejtë për vendosjen e mekanizmave më efikase për mbrojtjen e fëmijëve. Megjashi i përfaqëson dhe mbron të drejtat e fëmijëve, qëndron për prindër të përgjegjshëm dhe për respekt ndaj personalitetit të fëmijëve. Megjashi vazhdimisht punon në përforcimin e lëvizjes qytetare për të drejtat e fëmijëve dhe funksionalitetin nga ana e institucioneve në interes më të

<sup>55</sup> Seksualno zlostavljanje djece, <http://cnzd.org/edukacija/seksualno-zlostavljanje-djece/09.01.2019roa>

<sup>56</sup> Ballina e faqes së Ambasadës së Parë të Fëmijëve në Botë – Megjashi, <http://www.childrensembassy.org.mk/>

mirë për fëmijët. Ambasada e promovon aktivizmin dhe vullnetarizmin paqësor, duke zhvilluar qytetari aktive të bazuar mbi parimin e jodhunës.

Trupi Koordinues Kombëtar për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhimi në vitin 2017, i udhëhequr nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, ka hartuar Strategji për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna (2020-2025) dhe një Plan veprimi (2020-2022)<sup>57</sup>. Strategjia dhe Planin i Veprimit janë në përputhje me të gjitha dokumentet, rregulloret përkatëse ndërkombëtare të përcaktuara. Parimet themelore që mbështetin Strategjinë Kombëtare (2020-2025) dhe Planin e Veprimit (2020-2022) për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna janë respektimi dhe zbatimi i të drejtave të fëmijëve përmes zbatimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Qëllimi i strategjisë është që deri në vitin 2025, të krijojë një mjedis të sigurt për fëmijët që mundëson rritjen dhe zhvillimin e tij të plotë, përmes një sistemi të përparuar kombëtar për parandalimin dhe mbrojtjen e të gjitha formave të dhunës dhe përvojave të tjera negative të fëmijërisë si dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse të fëmijëve.

Si rezultat i rishikimit të literaturës, hulumtimeve përkatëse, dokumenteve dhe ligjeve kryesore kombëtare dhe konsultimeve me anëtarët e Trupit Koordinues Kombëtar për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhimi dhe ekspertë të tjerë kryesorë dhe palë të interesuara në vend, janë identifikuar gjashtë (6) priorite kryesore, nëntë (9) qëllime specifike dhe trembëdhjetë (13) indikatorë.

Gjashtë (6) prioritetet kryesore të kësaj strategjie dhe planit veprues janë:

- (1) Kuadri kombëtar strategjik dhe ligjor për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha llojet e dhunës.
- (2) Avancimi i diturive, praktikave dhe nxitje e qëndrimeve dhe vlerave për zero tolerancë ndaj dhunës.
- (3) Programe preventive të bazuara në fakte, në drejtim të pengimit të dhunës ndaj fëmijëve dhe forcim apo rritje të rrezistencës të fëmijët dhe familjet.

---

<sup>57</sup> Strategji për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna (2020-2025) dhe një Plan veprimi (2020-2022), <http://mtsp.gov.mk/dokumenti.nsp>



- (4) Kapacitetet e administratës dhe institucioneve për të dhënë një përgjigje ndërsektorale, për mbrojtje, trajtim të fëmijëve nga dhuna dhe përkrahja e tyre.
- (5) Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për fëmijët.
- (6) Sistemi për evidentim dhe ndjekje apo përcjellje të situatës së dhunës ndaj fëmijëve me qëllim krijimin e politikave dhe shërbimeve të bazuara në fakte.

## Kapitulli II

### Historiku i regjistrave të abuzuesve seksual

#### 1. Vështrime të përgjithshme

Keqpërdorimi seksual ndaj fëmijëve paraqet një nga format më të rënda të shkeljes të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, është një realitet global në të gjitha shetetet dhe grupet shoqërore dhe shfaqet në formën e abuzimit seksual, ngacmimit, dhunimit ose shfrytëzimit seksual përmes prostitucionit ose pornografisë.

Regjistri i veçantë për personat të dënuar për abuzim seksual ndaj fëmijëve konsiderohet si një ndër masat preventive për parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve. Qëllimi për ekzistimin e këtyre regjistrave është preventiv, mbron personat e mitur, nën kushtet dhe në procedurën e përcaktuar me ligj, ndihmon prindërit, kujdestarët, adoptuesit, punonjësit social, mësuesit dhe të gjithë ato të cileët punojnë për dhe me fëmijët, që të kenë njohuri lidhur me këta persona dhe të mund të parandalojnë viktimizimin e fëmijëve të tyre.

Regjistrat për abuzuesit seksual të fëmijëve janë të domosdoshëm nga që:

- Abuzuesit seksual janë në gjendje të përsërisin veprën pasi të kenë vuajtur dënimin apo masën ndëshkuese.
- Mbrojtja e publikut nga abuzuesit seksual është interes primar i qeverisë.
- Interesi privat i personave të dënuar për abuzim seksual ndaj fëmijëve është më pak i rëndësishëm se sa interesi i qeverisë për sigurinë e publikut.
- Dhënia e informatave të caktuara për abuzuesit seksual të fëmijëve ndihmon agjensitë publike dhe publikun në përgjithësi për sigurinë publike.<sup>58</sup>

Shtetet të cilët kanë ligje që rregullojnë sistemet e regjistrimit dhe njoftimit të abuzuesve seksual janë: Argjentina, Australia, Bermuda, Kanada, Franca, Gjermania, Irlanda, Xhamajka, Kenia, Maldivet, Malta, Ishujt Pitcairn, Afrika e Jugut, Korea e Jugut, Tajvani, Trinidad & Tobago,

---

<sup>58</sup> Megan's Law by State, <https://klaaskids.org/megans-law/>

Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Ndërsa disa shtete tjera si: Austria, Bahamas, Fixhi, Finlanda, Hong Kong, Izrael, Malajzi, Zelanda e Re, Zvicra, Emiratet Arabe dhe Zimbabve janë duke shqyrtuar ligjet e regjistrimit dhe njoftimit të abuzuesve seksual, por ligje të tilla nuk kanë ende.<sup>59</sup>

Në një artikull ishin trajtuar disa argumente “për dhe kundër” regjistrimit dhe njoftimit të abuzuesve seksual. Në argumentet “për” regjistrimin dhe njoftimin e abuzuesve seksual kishin përfshirë:

- të drejtën e publikut të dijë se në rrethin e tij jeton ndonjë abuzues seksual;
- krijimi i një regjistri ndihmon zbatimin e ligjit në hetim;
- pengon kryerësit të kryejnë vepra të reja;
- krijon baza ligjore që të njoh kryerësit.

Ndërsa si argumente “kundër” regjistrimit dhe njoftimit të abuzuesve seksual paraqiten:

- Shkel të drejtat dhe liritë e kryerësve;
- jo të gjithë kryerësit janë të regjistruar (psh. në rastet e pa raportuara, kryerësit do të mbeten të lirë dhe të pazbuluar);
- regjistrimi i kryerësve është program i shtrenjtë;
- në rastet e incestit viktimat mund të identifikohet në publik.<sup>60</sup>

## 2. SHBA

Sipas një studimi gjatë vitit 2018 kanë konstatuar se deri në atë vit janë identifikuar 904,011 abuzues seksual të regjistruar që jetojnë në Shtetet e Bashkuara, numër i cili është rritur nga 847,725 në nëntor, 2017. Ndërsa, FBI vlerëson se vetëm 10-40% e krimeve seksuale janë raportuar, që do të thotë se ka miliona abuzues seksual që jetojnë në Shtetet e Bashkuara, shumë prej të cilëve kurrë nuk janë raportuar, kapur, ose dënuar.<sup>61</sup>

Regjistri i abuzuesve seksual në SHBA fillimisht është krijuar në vitin 1994 me Aktin Jacob Wetterling (Jacob Wetterling Crimes Against Children and Sexually Violent Offender Registration Act), i cili mundësoi që abuzuesit seksual të regjistroheshin në një regjistër ku do të

<sup>59</sup> Global Overview of Sex Offender Registration and Notification Systems, 2014

<https://www.smart.gov/pdfs/GlobalOverview.pdf>

<sup>60</sup> Marie Swain, Registration of paedophiles (NSW Parliamentary library research service), Briefing Paper No 12/97

<sup>61</sup> Sex Offender Registration Map, (2018), National Center for Missing and Exploited Children

kishte qasje policia, por jo edhe publiku.<sup>62</sup> Viti kur u miratua Akti i Wetterling, 1994, ishte gjithashtu viti kur Megan Kanka shtatë vjeçare është dhunuar dhe vrarë nga fqinj i cili ishte dënuar dy herë si abuzues seksual. Legjislatorët në SHBA krijuan Regjistrin e abuzuesve seksual dhe Ligjin e Megan me qëllim që të mbrojnë komunitetet, dhe fëmijët në veçanti.<sup>63</sup>

Në vitin 1989, **Jacob Wetterling** 11 vjeç në St. Jozef, Minesota bashkë me vëllain e tij dhe shokun e tyre kanë qenë duke vozitur biçikletë kur një person i maskuar me armë ndaloi tre djemtë. Personi i maskuar la dy djemtë të ikin dhe rrëmbeu Jakobin. Njëzet e shtatë vjet pas zhdukjes së tij, eshtrat e Jakobit u gjetën përfundimisht. Familja Wetterling kurrë nuk hoqi dorë nga shpresa se ata do të gjenin të gjallë djalin e tyre. Në afro tre dekada që nga rrëmbimi i Jakobit, familja e tij ka luftuar për të krijuar dhe përmirësuar legjislacionin që të jetë në gjendje të parandalojë që kjo lloj tragjedie të mos ndodhë në një familje tjetër. Në vitin 2015, është arrestuar një burrë 54-vjeçar Danny Heinrich i dyshuar i mundshëm në rrëmbimin e Jakobit. Heinrich në 2016 pranoi në gjykatë fajin. Ai tregoi gjithashtu se Jakobi ishte rasti i fundit me të cilin kishte abuzuar.<sup>64</sup>

Sot informatat e përfshira në regjistër janë:

- Emri dhe pseudonimet e njohura;
- Mosha dhe gjinia;
- Përshkrimi fizik, përfshirë plagët, shenjat dhe tatuazhet;
- Fotografia;
- Krimet që rezultojnë në regjistrim; Adresa dhe Qarku i vendbanimit;
- Zip Code (bazuar në regjistrimin e fundit).<sup>65</sup>

Kryerësi i veprës në rastin e **Megan Kanka**, Jesse Timmendequas, pranoi se e kishte vrarë dhe përdhunuar Meganin. Timmendequas i tha policisë se kishte pasur frikë se Megan do ti tregonte nënës së saj që ai e kishte prekur dhe ishte përpjekur për ta puthur dhe se për ta

---

<sup>62</sup> Vandiver. D, Braithwaite. J, Stafford. M, Sex Crimes and Sex Offenders – Research and Realities, New York, 2017.

<sup>63</sup> Griffin. L, & Blacker. K, Megan's Law and Sarah's Law: A Comparative Study of Sex Offender Community Notification Schemes in the United States and the United Kingdom, 46 Crim. L. Bull. 987 (2010)

<sup>64</sup> What Is The Wetterling Act? Jacob Wetterling's Legacy Helped Make The World A Little Safer, <https://www.romper.com/p/what-is-the-wetterling-act-jacob-wetterlings-legacy-helped-make-the-world-a-little-safer-17752>

<sup>65</sup> Fresno County Sheriff's Office, [www.fresnosheriff.org](http://www.fresnosheriff.org)

tërhequr në shtëpinë e tij i kishte lejuar të ledhatonte këlyshin e tij. Ai e kishte përdhunuar Meganin, e kishte rrahur dhe kishte përdorur një rrip për ta ngulfatur atë. Përveç vrasjes me dashje, i pandehuri ishte gjithashtu i dënuar për rrëmbim, përdhunim, sodomi dhe vrasje. Ajo çfarë është e rëndësishme në këtë rast është se Timmendequas kishte dy dënime të mëparshme për sulme seksuale në vitet 1979 dhe 1981 dhe u dënua me vdekje për rastin e përdhunimit dhe vrasjes së Megan Kanka. Dënimi me vdekje i Timmendequas u kthye më vonë në burg të përjetshëm kur Shteti i New Jersey ndaloi dënimin me vdekje.<sup>66</sup>

**Adam John Walsh**, gjashtë vjeç, është rrëmbyer në një qendër tregtare në Hollywood, Florida, dhe më vonë është gjetur i vrarë. Më 27 korrik 2006, 25 vjet pasi Adami u zhduk, Presidenti George W. Bush nënshkroi Ligjin për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Fëmijëve (Adam Walsh Sex Offender Registration and Notification Act - SORNA), i cili krijoi një bazë të dhënash kombëtare për abuzuesit seksual të fëmijëve, forcoi dënimet federale për krimet ndaj fëmijëve dhe siguroi financimi dhe trajnimi për zbatimin e ligjit për të luftuar krimet që përfshijnë shfrytëzimin seksual të fëmijëve përmes internetit.<sup>67</sup> SORNA kërkon që abuzuesit seksual të regjistrohen në mbarë territorin dhe vendos dënime penale në rastet kur abuzuesit e dënuar dështojnë të regjistrohen.<sup>68</sup>

### 3. Mbretëria e Bashkuar

Regjistri i abuzuesve seksual u krijua me “Ligjin për abuzuesit seksual 1997” si një mënyrë për policinë e Mbretërisë së Bashkuar për të mbajtur gjurmët e kryerësve. Në Mbretërinë e Bashkuar të dhënat mbi regjistrin e abuzuesve seksual nuk janë të arritshme për publikun. Të dhënat rruhen përmes Multi-Agency Public Protection Arrangements (MAPPA), një sistem në Mbretërinë e Bashkuar përmes të cilit burgu dhe shërbimet policore në të gjithë Anglinë dhe Uellsin ndajnë informacion për të ndjekur abuzuesit seksual të rrezikshëm.

Akti mbi abuzuesit seksual të vitit 2003 u krijua për të siguruar dispozita të reja për krimet seksuale, parandalimin e tyre dhe mbrojtjen e fëmijëve. Kërkesa për njoftim në Aktin mbi abuzuesit seksual e vitit 2003 përcakton që dhunuesit e dënuar seksual të regjistrohen në

---

<sup>66</sup> Kielsingardf, M. (2014), Myth-driven state policy: an international perspective of recidivism and incurability of pedophile offenders.

<sup>67</sup> Six-year-old Adam Walsh is abducted, <https://www.history.com/this-day-in-history/adam-walsh-is-abducted>

<sup>68</sup> Griffin. L, & Blacker. K, Megan's Law and Sarah's Law: A Comparative Study of Sex Offender Community Notification Schemes in the United States and the United Kingdom, 46 Crim. L. Bull. 987 (2010)

njësinë e tyre lokale policore. Dhunuesit duhet të njoftojnë policinë në periudhë prej 3 ditësh nga dënimi dhe duhet të qëndrojnë në regjistër për një periudhë të caktuar varësisht nga lartësia e dënimit të tyre. Ato duhet të qëndrojnë në regjistër më së paku 7 vite.<sup>69</sup>

Të dhënat që abuzuesit duhet t'i japin policisë përfshin: emrin e tyre, datën e lindjes, numrin e sigurimeve kombëtare, adresën dhe informacione të tjera të përcaktuara nga Sekretari i Shtetit. Përveç kësaj, abuzuesi duhet të lejojë policinë të marrë shenjat e gishtërinjëve dhe fotografi.<sup>70</sup> Dhunuesit që planifikojnë të udhëtojnë jashtë Mbretërisë së Bashkuar, duhet të njoftojnë policinë përpara datës së planifikuar për udhëtim, shtetin apo shtetet ku do të udhëtojnë dhe çdo informacion të rëndësishëm. Dhunuesi që nuk u përmbahet kërkesave të njoftimit mund të jetë subjekt i gjobave dhe dënimit prej maksimalisht 5 vite burg.<sup>71</sup>

Në korrik 2000, **Sarah Payne** tetë vjeçare u rrëmbye gjatë kohës që luante jashtë shtëpisë së gjyshërve të saj në West Sussex. Trupi i saj u gjet disa ditë më vonë. Roy Whiting, i cili jetoi afro pesë milje larg nga skena e zhdukjes së Sarës, u akuzua për rrëmbim dhe vrasjen e saj. Pas bindjes së tij në dhjetor të 2001 doli që ai ishte në regjistrin e abuzuesve seksual si rezultat i një dënimi të mëparshëm për rrëmbim dhe sulm të pavendosur të një vajze tjetër të re.<sup>72</sup>

Prindërit e saj, propozuan Ligjin e Sarës, i cili bënte thirrje që Mbretëria e Bashkuar të shpallte emrat e dhunuesve lokal seksual, ashtu siç ishin publikuar në SHBA te Ligji I Meganit. Në reagim të vdekjes së Sarah Paynit dhe të shqetësuar se regjistri i dhunuesve seksual nuk ishte publikuar, News of the World, një gazetë tabloidi britanike, pretendonte se do të krijonte një sistem të vetin të njoftimit publik. Gazeta realizoi kampanjën “emëro dhe turpëro” të të gjithë dhunuesve seksual në Mbretërinë e Bashkuar duke postuar informacionet e tyre në internet. Pas informacioneve të publikuara në faqe, disa qytetarë sulmuan dhe ngacmuan disa nga dhunuesit seksual. Për pasojë, qeveria urdhëroi që gazeta të largojë këto informacione.<sup>73</sup>

---

<sup>69</sup> Griffin. L, & Blacker. K, Megan's Law and Sarah's Law: A Comparative Study of Sex Offender Community Notification Schemes in the United States and the United Kingdom, 46 Crim. L. Bull. (2010)

<sup>70</sup> Po aty.

<sup>71</sup> Po aty.

<sup>72</sup> Lipscombe. S, Sarah's law: the child sex offender disclosure scheme, 2012

<sup>73</sup> Griffin. L, & Blacker. K, Megan's Law and Sarah's Law: A Comparative Study of Sex Offender Community Notification Schemes in the United States and the United Kingdom, 46 Crim. L. Bull. (2010)

## 4. Korea e Jugut

Akti i Mbrojtjes Seksuale të Rinisë së Koresë së Jugut (2000) siguroi që dy herë në vit Komisioni i Koresë për Mbrojtjen e Rinisë (KCYP) do t'i sigurojë publikut emrat e abuzuesve të dënuar seksual që kanë viktimizuar fëmijë. Njoftimi i parë publik në gusht 2001 zbuloi identitetin e 169 abuzuesve të tillë. Synimi i aktit është të parandalojë krimet seksuale ndaj të miturve duke "rritur ndërgjegjësimin e publikut" për krimin.<sup>74</sup> Sipas komisionit, 38,5 përqind e 169 abuzuesve në list u dënuan për përdhunim, 28 përqind për dhunë seksuale dhe 16 përqind për shitje të fëmijëve për kryerje të aktit seksual. Gjashtëmbëdhjetë prej të cilëve u dënuan për detyrimin e të miturve në prostitucion. Më shumë se 30 përqind e 242 viktimave të 169 kryerësve të dënuar ishin më të vegjël se 13 vjeç. Nga 169 abuzuesit 133 nga ato nuk i njihnin viktimat e tyre, ndërsa në listë ishin tre raste incesti. Nga 169 kryerësit 21 përqind ishin të papunë, 19 përqind ishin punëtorë të jakës së bardhë dhe 17 përqind ishin pronarë të bizneseve të vogla.<sup>75</sup>

Qasja në të dhënat e regjistrimit mundësohet nëpërmjet faqes së internetit [www.sexoffender.go.kr](http://www.sexoffender.go.kr). Ky regjistër përmban:

- Emrin dhe numrin e regjistruarit;
- Adresën;
- Profesionin, punën dhe adresën e punës;
- Fotografinë, përshkrimin fizik, moshën;
- Numrin e regjistrimit të veturës;
- Numrin e lëndës, emrin i krimit, faktet e grumbulluara;
- Datën e dënimit dhe dënimin e shqiptuar.<sup>76</sup>

<sup>74</sup> National criminal justice reference service, <http://www.ncjrs.gov/App/publications/abstract.aspx?ID=210600>

<sup>75</sup> Korea Puts Sex Offenders Online, <https://www.wired.com/2001/08/korea-puts-sex-offenders-online/>

<sup>76</sup> Meredith G. F. Worthen Sexual Deviance and Society: A sociological examination, 2016

## 5. Maldivet

Sipas Ligjit për ndëshkimet e rrepta ndaj abuzuesve seksual të fëmijëve të vitit 2009, shumica e abuzuesve janë të dënuar me 10 deri në 20 vite burg. Neni 77 i legjislacionit të lartpërmendur, jo vetëm që i detyron autoritetet të bëjnë publike identitetin e shkelësve të dënuar me ligj, por gjithashtu u thotë autoriteteve që të krijojnë një faqe në internet përmes së cilës, publiku mund të dijë se kush janë shkelësit seksual.<sup>77</sup>

Sipas nenit 57 të Ligjit për dispozita të veçanta që ka të bëjë me kryerësit e abuzimit të seksual të fëmijëve, Agjensia shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, duhet të publikojë dhe të informojë publikun për personat që kryejnë shkeljen e këtij ligji. Në këtë drejtim, për sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve nga këto abuzues si dhe për të eliminuar mundësitë për përsëritjen e veprave të tilla, informatat në lidhje me abuzuesit duhet të publikohen në një uebfaqe interneti si dhe duhet të vendoset një mekanizëm për të identifikuar abuzuesit përmes numrave të tyre identifikues nëpërmjet mesazheve të shkurtra.<sup>78</sup>

Informatat merren dhe verifikohen nga autoritetet përkatëse përfshirë: Shërbimin Policor i Maldiveve, Gjykata Penale, Shërbimi Korrektues i Maldiveve, Gjykatat e magistratës dhe Këshilli i Ishujve. Të dhënat për abuzuesit seksual të fëmijëve do të ndihmojnë prindërit, menaxhmin e shkollave, punëdhënësit dhe banorët e tjerë të interesuar që të identifikojnë detaje të rëndësishme të abuzuesve që janë dënuar për abuzim seksual ndaj fëmijëve sipas Ligjit 12/2009. Në faqen e internetit mund të kërkojnë vendndodhjen e abuzuesve, kohëzgjatjen dhe plotësimin e dënimit. Abuzuesit mund të kërkojnë sipas emrit të tyre, numrit të kartës së identitetit kombëtar ose ishullit që i përkasin. Të dhënat e abuzuesit do të mbeten publike për 10 vjet të tjera edhe pse ai ose ajo ka përfunduar dënimin e tij.<sup>79</sup>

---

<sup>77</sup> Meredith G. F. Worthen Sexual Deviance and Society: A sociological examination, 2016, <https://minivannewsarchive.com/politics/one-in-seven-children-of-secondary-school-age-suffered-sexual-abuse-in-the-maldives-39063>

<sup>78</sup> Ligjit për dispozita të veçanta që ka të bëjë me kryerësit e abuzimit të seksual të fëmijëve, neni 57 <http://agoffice.gov.mv/pdf/sublawe/CSAO.pdf>

<sup>79</sup> Child sex offender registry, Maldives <http://www.offenders.mv/>



## Kapitulli III

### Regjistri për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV

#### 1. Vështrime të përgjithshme

Duke ndërmarrë masa të caktuara për të ushtruar në mënyrë më efektive të drejtat e fëmijëve, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së veriut dhe ligjeve, si dhe në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, vitet e fundit vëmendje e veçantë i është kushtuar problemit të fëmijëve viktime të abuzimit seksual dhe pedofilisë.

Në këtë drejtim, u miratua Ligji për Regjistrin e veçantë për personat e dënuar për vepra penale për abuzim seksual të fëmijëve dhe pedofilisë.<sup>80</sup> Viteve të fundit, në vendin tonë ka pasur reagime të shumta shoqërore në shumë nivele, përfshirë këtu viktimat dhe autorët e krimit. Situata në këtë fushë po monitorohet, mangësitë identifikohen dhe përmirësohen shpejt, dhe po kështu ndryshimet legislative kanë për qëllim futjen e regjistrit dhe rritjen e dënimeve me burg.

Hulumtimet në nivel botëror tregojnë se nuk ka asnjë trajtim që të jep rezultate të besueshme pozitive dhe garancë maksimale të recidivizmit tek shkelësit. Çdo person i dënuar duhet të marrë trajtim individual dhe të individualizuar, në varësi të gjendjes së tij shëndetësore dhe psiko-fizike, rreziqeve, nivelit të devijimit të sjelljes së tij, si dhe motivimit të tij për korrigjim dhe ndryshim. Dënimi me burg nuk duhet të jetë një sanksion i vetëm pa trajtimin psikologjik dhe psikiatrik të cilin ata do të marrin gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit, si dhe ndihmën dhe mbështetjen sociale pas procesit të riintegrit. Është thelbësore që dënimi me burg të kombinohet me forma të tjera të trajtimit psikologjik dhe psikiatrik, d.m.th., përfshirje e detyrueshme e abuzuesve në programet e trajtimit gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit. Këtë e tregojnë edhe përvojat e vendeve të tjera.

Grupi i punës që punoi për prezantimin e Regjistrit dhe ligjit, ka ndjekur hulumtimet në nivel botëror, ekzistencën e një regjistri të tillë ose të ngjashëm, në vendet e tjera dhe efektin e ekzistencës së tyre.

---

<sup>80</sup> Petrovska.N, profesoreshë e shkencaave pedagogjike, Enti për punë sociale

Regjistri i veçantë u promovua në 01.06.2012 nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe në të janë përfshirë të gjithë të dënuarit që aktualisht vuajnë dënime me burg për vepra të përcaktuara në këtë ligj, pavarësisht nga viti kur është kryer vepra dhe nga fillimi i burgimit. Prandaj theksohet se numri i të dënuarve që janë shpallur në Regjistër në vitin 2012, nuk ka të bëjë me vitin e theksuar dhe nuk duhet të merren si bazë për krijimin e analizave krahasuese.

Regjistri i veçantë përmban të dhëna për personat e dënuar për gjithsej 11 vepra penale kundër lirisë gjinore dhe seksuale të kryera ndaj fëmijëve. Të dhënat e publikuara në Regjistrin Elektronik përfshijnë të dhëna kryesore të personave, gjegjësisht: emri, mbiemri dhe pseudonimi, data e lindjes, adresa e vendbanimit ose vendbanimi, vepra penale për të cilën janë dënuar, lartësia e dënimit, fillimi, përfundimi ose ndryshimi i dënimit me burg si dhe fotografi. Këto të dhëna janë në dispozicion të publikut.

Nevoja për krijimin e një Regjistri të tillë, ishte si pasojë e rritjes së numrit të kryerësve që janë përsëritës të veprave penale. Sipas një analize të vendimeve gjyqësore nga periudha janar 2004 deri më vitin 2009, nga 231 personave të dënuar, 191 janë kryerës të veprave për herë të parë, 38 apo 16% janë përsëritës të veprave, nga të cilët 26 janë përsëritës të njëfishtë kurse 12 janë kryerës të shumëfishtë.<sup>81</sup>

Nga viti 2013 e deri sot, në këtë Regjistër publikohen personat që fillojnë të vuajnë dënimin me burg, pas një aktgjykimi të formës së prerë, në vitin aktual. Të dhënat për fëmijët viktime, nuk janë të disponueshme publikisht. Të dhënat për të dënuarit që vuajnë dënimin me burg në Institucionet Ndëshkuese-Korrektuese merren nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, kurse fotografitë e të dënuarve merren nga Ministria e punëve të brendshme.

Enti për punë sociale në Shkup, i cili monitoron dhe studjon fenomene sociale si dhe promovon veprimtaritë shoqërore, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren, është i autorizuar të mbajë në evidencë Regjistrin e veçantë për personat e dënuar si dhe ti publikonjë në faqen e internetit.

---

<sup>81</sup> Që sot të dhënat e pedofilëve të gjykuar në internet, marrë nga: <https://vlada.mk/node/3347>

Deri më 31.12.2018, në këtë Regjistër janë regjistruar 248 persona të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për krime kundër lirisë seksuale dhe vepra seksuale të kryera ndaj fëmijëve. Deri më tani, 100 persona janë liruar, pasi kanë vuajtur dënimin me burg. Sipas analizës nga Enti për punë sociale, shumica e autorëve të dhunës seksuale të fëmijëve të regjistruar në Regjistër janë meshkuj, pra 237 ose (95.5%). Vetëm 4.5% janë femra që shpesh janë bashkëpunëtore dhe ndihmëse të meshkujve, e jo autorë të drejtpërdrejtë. Në 2 vitet e fundit, gjegjësisht në 2017 dhe 2018 në Regjistër nuk ka femra të regjistruara. Analiza e të dënuarve sipas gjinisë tregon një ndryshim jo vetëm në aspektin e sasisë së dënimit, por edhe në llojin e veprave penale. Femrat shpesh merren me trafikim fëmijësh dhe nxisin dhe mundësojnë aktivitet seksual, ndërsa meshkujt më shpesh janë kryes të sulmeve seksuale ndaj fëmijëve nën moshën 14 vjeç.

Analiza e moshës së të dënuarve në kohën e kryerjes së krimit tregon se ato i përkasin të gjitha kategorive të moshave. Vrasësi më i vjetër i regjistruar në Regjistrin në kohën e krimit ishte 73 vjeç dhe fëmija viktimë ishte 9 vjeç. Dallimi midis abuzuesit dhe fëmijës është 64 vjet. Sidoqoftë, shumica e kryerësve të regjistruar në Regjistër në kohën e krimit ishin të moshës 18-40 vjeç, pra 66% të totalit. Nëse bëjmë një analizë më të thellë, shohim se më dominues janë të dënuarit të ndarë në dy kategori: 18-24 vjet dhe 31-40 vjet, përkatësisht, janë të përfaqësuar me 24% në secilën kategori ose bashkarisht 121 autorë (48%). Por nuk duhet anashkaluar faktin që 16 autorë, në kohën e krimit kanë qenë mbi 60 vjeç.

Me krijimin e Regjistrit të veçantë u vendos një evidencë unike dhe u krijua një bazë e të dhënave që mund të përdoren për monitorimin e çështjes, krahasimin e saj, përmirësimin e kornizës ligjore si dhe punën për parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve. Kjo është një masë pozitive e sigurisë para së gjithash për fëmijët, duke mbajtur në konsideratë të drejtën e fëmijës për një fëmijëri të sigurt, si dhe sensibilizimin e publikut të gjerë për këtë fenomen, ngritjen e nivelit kulturor, shoqëror dhe arsimor të qytetarëve për ta njohur atë. Në këtë mënyrë bëhet parandalimi parësor në kontekstin e ndërjegjësimit të publikut për pasojat e mundshme, sanksionet dhe parandalimin e veprimtarive të abuzuesve të mundshëm.

Por theksi i veçantë është te fëmijët që janë viktimat të abuzimit seksual, pasi atyre u jepet siguri më e madhe duke pasur parasysh faktin se autori i krimit po vuan një dënim të gjatë me burg, që është i mjaftueshëm për rivendosjen dhe riintegrimin e tyre të suksesshëm në rrjedhën

normale të jetës. Rritja e dënimit me burgim të kundërvajtësit gjithashtu do të ketë një ndikim pozitiv te prindërit ose familjet e fëmijës-viktimë, për të tejkaluar traumat dhe të sigurojë ndihmë dhe mbështetje fëmijës.

Enti për punë sociale në Shkup, si institucion që monitoron dhe studjon fenomenet shoqërore dhe promovon veprimtari shoqërore, është i autorizuar të kujdeset për Regjistrin e Personave të Dënuar dhe t'i publikojë ato në faqen e internetit, në pajtim me Ligjin për Regjistrin e veçantë për personat e dënuar për krime të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë (Gazeta Zyrtare nr.11, nga 24.01.2012) si dhe Rregulloren për mënyrën e futjes së të dhënave të personave të dënuar në Regjistrin e veçantë të personave të dënuar për abuzim seksual të të miturve dhe pedofili dhe mënyrën e njoftimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë (Gazeta Zyrtare No.62/2012 nga 21.05.2012).

Në një intervistë me Znj. Ellka Todorevsa<sup>82</sup> administratore e lartë në Ministrinë e punës dhe politikës sociale, në Departamentin për mbrojtje shoqërore-familjare dhe juridike të fëmijëve dhe familjes, theksoi se Regjistri është me karakter publik, i arritshëm për të gjithë qytetarët dhe duke shfletuar në Regjistrin, mund të merren informata për njerëzit që jetojnë në rrethinat e tyre të cilët janë të dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me abuzimin seksual të të miturve dhe pedofilinë. Publiku është i informuar për ekzistencën e këtij Regjistri, e kjo vërehet nga numri i vizitave dhe kërkimet e bëra në të, si dhe nga interesimi i ekspertëve dhe profesionistëve që hulumtojnë këtë çështje dhe kërkojnë informacione dhe mediat që shpesh kërkojnë të dhëna. Regjistri përdoret nga institucione arsimore dhe institucione të tjera që punësojnë njerëz për punë me fëmijë, për kujdesje familjare, etj.

Që nga themelimi i Regjistrit të veçantë në datën 01.06.2012, deri më tani regjistrohen rregullisht dhe në vazhdimësi, vetëm ata që janë dënuar me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës, pasi të kenë marrë njoftimin nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, në përputhje me Ligjin. Që nga prezantimi i Regjistrit (Qershor 2012) e deri më tani, janë publikuar gjithsej 257 persona.

---

<sup>82</sup> Todorevska.E, Ministria e punës dhe politikës sociale - Departamenti për mbrojtje shoqërore-familjare dhe juridike të fëmijëve dhe familjes

**Tabela 2:** Personat e shpallur në Regjistrin e Veçantë për Personat e Dënuar për Vepra Penale të Abuzimit Seksual të Fëmijëve dhe Pedofilisë nga 2012-2020

	Personat e shpallur në Regjistrin e pedofilëve
<b>Viti 2012</b>	<b>116</b>
<b>Viti 2013</b>	<b>28</b>
<b>Viti 2014</b>	<b>20</b>
<b>Viti 2015</b>	<b>39</b>
<b>Viti 2016</b>	<b>16</b>
<b>Viti 2017</b>	<b>15</b>
<b>Viti 2018</b>	<b>14</b>
<b>Viti 2019</b>	<b>8</b>
<b>Viti 2020</b>	<b>1</b>
<b>Gjithësej:</b>	<b>257</b>

Nga tabela më lart, 109 prej tyre janë liruar dhe kjo është theksuar edhe në Regjistër si pjesë e statusit të tyre, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e popullatës dhe fëmijëve, kurse pjesa tjetër ende vuan dënimet me burg.

Që nga themelimi i saj në 2012 deri sot, Regjistri ka qenë në funksionim të vazhdueshëm, me ndërprerje të vogla të një natyre teknike ose për shkak të azhurnimit dhe përmirësimit të tij. Këto ndërprerje tentohet të regullohen shpejt dhe me efikasitet dhe ta vendosen në dispozicion të publikut. Regjistri që nga krijimi i tij deri më sot azhurohet vazhdimisht me të dhëna të reja, d.m.th pasi të ketë marrë informacion nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve brenda afatit dhe në mënyrën e parashikuar me ligj.

Trupi Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Dhunës, Abuzimit dhe Neglizhencës, ka hartuar Strategji dhe Plan veprimi që përmban aktivitete parandaluese për mbrojtjen e fëmijëve dhe informimin e tyre. Por deri më tani, çdo sektor i përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve ka punuar në zhvillimin e materialeve të ndryshme dhe punëtorive informative-edukuese për fëmijë, prindër, kujdestarë dhe mësues.

Në sistemin e mbrojtjes sociale, Enti për punë sociale në Shkup, në përputhje me Programin për arsimim të vazhdueshëm profesional, zhvillon trajnime për këtë temë të profesionistëve që punojnë në qendrat për punë sociale dhe institucionet tjera për licencimin e tyre. Njëkohësisht, Enti për punë sociale përgatit materiale informuese: si për shembull fletushka për mbrojtjen e nxënësve nga abuzimi seksual, për mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme dhe prindërit e nxënësve ("Me edukim dhe dituri deri në parandalim nga abuzimi seksual"), si dhe materiale tjera informative nëpër institucione.

## **2. Ligji mbi regjistrin e veçantë**

Në vitin 2012, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale miratoi Ligjin për Regjistrin e veçantë për personat e dënuar me dënim të plotëfuqishëm, për vepra penale abuzim seksual të fëmijëve dhe pedofili, e më vonë edhe Regulloren për mënyrën e futjes së të dhënave në Regjistrin e veçantë dhe mënyrën e raportimit dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë. Gjatë hartimit të ligjit u përdor përvoja nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në vitin 2014 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrin e veçantë për personat e dënuar për vepra penale për abuzim seksual të të miturve dhe pedofilisë (Gazeta Zyrtare, nr.112/2014). Me këto ndryshime u sollën zgjidhje më të mira për të dhënat që duhet të regjistrohen në regjistër, u bë harmonizimi i veprave penale me ndryshimet në Kodin Penal dhe specifikimin e të dhënave në Regjistrin e veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit ndaj fëmijëve. Paralelisht me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal në atë periudhë (Gazeta Zyrtare nr.27/2014) u bënë ndryshime në fushën e sanksioneve, d.m.th. u rritën dënimet me burg. Sipas nenit 2 të këtij Ligji "Qëllimi i ligjit dhe ndryshimi i tij është sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve nga keqpërdorimi seksual, pedofilia dhe tregtia me persona të mitur nëpërmjet qasjes së informative për personat që jetojnë në rrethinën e tyre, e që janë të dënuar për vepra

penale lidhur me keqpërdorimin seksual të personave të mitur, pedofili dhe tregti me persona të mitur.”<sup>83</sup>

Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Regjistrimit në vitin 2014:

- u shtua vepra penale e nenit 186 paragrafi i 2 “Dhunimi” dhe vepra penale e nenit 187 paragrafi i 2 “Abuzim ndaj personit të paaftë (të pafuqishëm)”;

- në nenin 190 “Kënaqja e epsheve seksuale para tjetrit” përveç paragrafit 2 shtohet edhe paragrafi i 3, poashtu i përfshirë në Kodin Penal;

- paragrafët 4 dhe 5 të nenit 191 “Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit” hiqen dhe zëvendësohen me nenin 191-a “Prostitucioni i fëmijëve”;

- hiqet vepra penale (e përfshirë në Kodin Penal) “Shtytje dhe mundësim i akteve seksuale” neni 192;

- në veprën penale të “Incestit” neni 194 theksohet vetëm paragrafi i 2.

Në nenin 4 të Ligjit shtohen të dhënat të cilat do të ofrohen për publikun në regjistrim. Në vazhdim të nenit 6 do të shtohen edhe dy nene të tjera 6-a dhe 6-b, nëpërmjet të cilave do të specifikohen organet përgjegjëse për dorëzimin e të dhënave (në këtë rast Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve dhe Ministria e Punëve të Brendshme deri te Enti për punë sociale) dhe përcaktimi i afatit kohor për dorëzimin e këtyre të dhënave.

Sipas nenit 7 të këtij Ligji “Personat e dënuar për vepra penale të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, pas kalimit të dënimit të shqiptuar, janë të detyruar që së paku një herë në vit pesë ditë para ditëlindjes së tyre, deri në fund të jetës së tyre të paraqiten të organi kompetent gjyqësor në vendin ku jetojnë dhe qëndrojnë”.<sup>84</sup> Për mos zbatimin e këtij neni personat e lartpërmendur do të dënohen me gjobë apo me burgim deri në 1 vit. (Neni 9)

Qytetarët janë të obliguar të paraqesin personat e dënuar në rast se do t’i vërejnë shpesh të njëjtit në afërsi të çerdheve, shkollave, parqe për fëmijë, vende rekreative për fëmijë apo vende për lojëra. Personave të dënuar së pari do t’ju jepet vërejtje gojarisht nga ana e Ministrisë të Punëve të Brendshme, ndërsa për herë të dytë do t’ju shqiptohet dënim me gjobë apo burgim me kohëzgjatje deri në një vit. (Neni 8 dhe 9)

---

<sup>83</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrimin e veçantë për personat e dënuar për vepra penale për abuzim seksual të të miturve dhe pedofilisë, neni 2 Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.112 / 2014

<sup>84</sup> Po aty, neni 7, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.112 / 2014

Çdo person i regjistruar do të dënohet gjithashtu me gjobë apo burgim deri në 1 vit në rast se pas vuajtjes së dënimit nuk do të paraqesë ndryshimin e të dhënave personale ose vendbanimit, te organi gjyqësorë kompetent. (Neni 9)

Personat e dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve, pedofili apo tregti me persona të mitur kanë të drejtë të kërkojnë heqjen e të dhënave nga regjistri pas 10 viteve nga skadimi i dënimit të vuajtur, si dhe me kusht që të mos e përsërisin veprën e kryer apo ndonjë vepër tjetër të këtij lloji (Neni 10). Kjo kërkesë do të shqyrtohet dhe do të vendoset nga organi gjyqësor kompetent në konsultim me Entin për punë sociale, ndërsa obligimi për paraqitjen e rregullt te organi gjyqësor kompetent (një herë në vit) do të mbetet deri në fund të jetës. (Neni 11)

Dënim me para apo burg me kohëzgjatje deri në 6 muaj është parashikuar në nenin 12 të ligjit, për qytetarët të cilët do të keqpërdorin të dhënat nga regjistri.

### **3. Web portali [www.registarnapedofili.com](http://www.registarnapedofili.com)**

Në Kodin Penal të RMV në kapitullin e nëntëmbëdhjetë janë të shfaqura “Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor”. Web portali [www.registarnapedofili.com](http://www.registarnapedofili.com) mundëson kyçje në një regjistër të veçantë online ku jepen të dhënat e personave të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual dhe pedofili ndaj fëmijëve në RMV. Regjistri i publikuar në internet është i hapur dhe të dhënat në regjistër janë të arritshme nga të gjithë.

Në momentin e hapjes së faqes në internet do të na paraqitet një dritare në të cilën shkruan: “Paralajmërim! Në pajtim me ligjin, nëse i keqpërdorni të dhënat të paraqitura në këtë regjistër, me qëllim të kërcënimit, frikësimit, shqetësimit të personave të dënuar apo anëtarëve të familjes së tyre apo në mënyrë tjetër i keqpërdorni të dhënat, do të dënoheni me dënim me të holla apo dënim me burg prej gjashtë muajve”. Duke kuptuar rëndësinë e fjalëve të shënuara klikojmë poshtë dritares në butonin “pranoj”, pas të cilës dritare shfaqet faqja kryesore e regjistrit.

Shërbimet të cilat ofrohen në këtë regjistër janë:

**Fillimi** - Kjo faqe në internet ofron një kërkim për njerëzit e dënuar për pedofili, ofron informacione se si të merremi me të dhe të parandalojmë pedofilinë.



**Kërko** - Këtu është e mundur të kërkoni personat e dënuar për pedofili me emrin, mbiemrin, vendbanimin dhe rrugën.

**Pyetje dhe përgjigje** - Ofron përgjigje për pyetjet e bëra më shpesh në lidhje me pedofilinë.

**Parandalimi dhe edukimi** - Siguron këshilla për t'ju edukuar se si të parandaloni pedofilinë. Ndërsa numri 15 505 është shfaqur në anën e djathtë të faqes për të paraqitur incidentet.

Personat e dënuar mund të kërkohen sipas emrit, mbiemrit, vendit dhe sipas adresës së vendbanimit. Në të dhënat e personave të dënuar me aktvendim të plotfuqishëm do të gjejmë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, pseudonimin, datëlindjen, adresën e vendbanimit ose vendqëndrimit, veprën penale për të cilën në mënyrë të plotfuqishme është dënuar, kohëzgjatjen e dënimit, datën e fillimit të mbajtjes së dënimit, datën e ndërprerjes së vuajtjes së dënimit, ndryshimet gjatë mbajtjes së dënimit, datën e lëshimit të vuajtjes së dënimit me burg, datën e fshirjes nga regjistri, fotografinë dhe vërejtje.

Në faqen online të regjistrit gjejmë edhe disa nga pyetjet më të parashtruara për pedofilinë dhe përgjigjet që janë dhënë për publikun. Përgjigjet janë të formuluara si udhëzues apo si këshilla për prindërit, mësuesit, kujdestarët, mjekët, secilin që punon me apo për fëmijët apo thjesht është i interesuar në lidhje me këto tema.

### **Pse fëmijët frigohen të tregojnë?**

- Fëmijët shpesh fshihen se janë abuzuar seksualisht dhe për këtë nuk i tregojnë askujt, por pengesat duhet të tejkalohen përmes bisedës së hapur për këtë temë.
- Viktimat shpesh heshtin dhe nuk i tregojnë askujt çfarë u ndodhi atyre për shkak të ndjenjës së turpërimit, fajit dhe frikës.
- Fëmijët nuk tregojnë sepse kanë frikë të mos i zhgënjejnë prindërit e tyre dhe të mos e "dëmtojnë" nderin e familjes.
- Autorët i manipulojnë fëmijët dhe shumë shpesh përpiqen t'i ngatërrojnë për atë çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe.
- Shumë autorë i bindin fëmijët më të vegjël se kjo është "lojë" dhe se "gjithçka është në rregull".

- Disa fëmijë viktime të abuzimit janë në një moshë shumë të re për të kuptuar se janë abuzuar dhe nuk e kuptojnë se çfarë u ndodhi atyre megjithatë shpesh ndodh që fëmijët nuk dijnë se si dhe ku të kërkojnë ndihmë.

- Autorët e kërcënojnë fëmijën për të mos treguar atë që i ndodhi.

Sigurisht, këto janë vetëm disa nga arsyet pse fëmijët që janë ekspozuar ndaj abuzimit seksual nuk e kanë raportuar atë.

### **Mësoni si komunikojnë fëmijët**

- Fëmijët të cilët janë abuzuar seksualisht, për atë që u ka ndodhë, ata i tregojnë një të rrituri te i cili kanë besim. Prandaj, edukimi i njerëzve që punojnë me fëmijë është shumë i rëndësishëm në procesin e zbulimit të abuzimit.

- Fëmijët mund të tregojnë vetëm disa pjesë të asaj që u ka ndodhë atyre ose të pretendojnë se kjo i ka ndodhë dikujt tjetër.

- Fëmijët shpesh do të ndalojnë së foluri nëse personi me të cilin flasin reagon emocionalisht ose negativisht.

### **Flisni hapur me fëmijët tuaj**

- Bisedoni me fëmijët tuaj për trupin e tyre, çfarë është abuzimi seksual, çfarë moshe është e përshtatshme për fillimin e aktiviteteve seksuale. Mësojini ata të flasin hapur me ju për të gjitha temat, përfshirë këtu edhe seksin.

- Bëhuni një model pozitiv për mënyrën se si kujdeseni për trupin tuaj, mësoni fëmijët të kujdesen për trupin e tyre.

- Mësoni fëmijët se të rriturit nuk duhet të ngacmojnë seksualisht fëmijët, mësojuni atyre cilat pjesë të trupit të tyre nuk duhet t'i prekin të tjerët.

- Bisedoni me fëmijët tuaj se kryerësi i abuzimit seksual mund të jetë një i afërm, anëtar i familjes, një shok apo një fëmijë më i madh.

- Mësoni fëmijët të mos japin numrin e tyre të telefonit, adresën e shtëpisë dhe emailin, kur ata janë të kyçur në internet.

- Kujdeseni se si fëmijët përdorin internetin. Autorët gjithnjë e më shumë përdorin internetin për të krijuar kontakte me fëmijët.

- Nëse fëmija është i pakënaqur ose shmang të qenit pranë një të rrituri, pyesni Pse? A ka ndonjë arsye për këtë?

Këshillat të cilat ofrohen në lidhje me preventivën dhe edukimin janë:

- Mos nguroni dhe kërkoni ndihmë profesionale.
- Asnjëherë mos e fajësoni fëmijën për çfarëdo forme të abuzimit.
- Inkurajoni të bisedojnë me ju në këtë temë.
- Tregoni dhe siguroni ato se përkundër ngjarjes së pafat, ju prap në të ardhmen do t'i doni, respektoni dhe mbronin ato.
- Besoni, të keni besim ndaj thënieve (fjalëve), pasi fëmija po thuhet asnjëherë nuk rren për abuzimin.

#### **4. Veprat penale e Kodit Penal të përfshira në Regjistër**

Regjistri përmban të dhëna për personat e dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor për persona të mitur.

Veprat penale e Kodit Penal të përfshira në Regjistër janë:

4.1 Dhunimi (neni 186 paragrafi 2)

4.2 Abuzim ndaj personit të paaftë (të pafuqishëm) (neni 187 paragrafi 2)

4.3 Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet (neni 188)

4.4 Abuzim me keqpërdorim të pozitës (neni 189 paragrafi 2)

4.5 Kënaqja e epsheve seksuale para tjetrit (neni 190 paragrafi 2 dhe 3)

4.6 Prostitucioni i fëmijëve (neni 191-a)

4.7 Tregimi i materialeve pornografike fëmijës (neni 193)

4.8 Prodhim dhe distribuimi pornografisë së fëmijëve (neni 193-a)

4.9 Mashtrim për abuzim ose veprim tjetër seksual ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet (neni 193-b)

4.10 Incesti (neni 194 paragrafi 2)

4.11 Tregti me fëmijë (neni 418-g)<sup>85</sup>

---

<sup>85</sup> Ligji për Regjistrin e veçantë të personave të dënuar për krime të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili, neni 3, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.11/2012, 112/2014

#### **4.1 Dhunimi (neni 186 paragrafi 2)**

Sipas paragrafit të dytë të këtij nëse vepra penale e dhunimit është kryer ndaj fëmijës i cili ka mbushur 14 vjet, kryerësi do të dënohet më së paku dhjetë vjet burgim. Dhunimi mund të realizohet nëpërmjet përdorimit të forcës ose duke e vënë viktimën në gjendje të pavetëdijshme duke përdorur medikamente apo drogë dehëse. Dhunimi është një ndër veprat më të rënda kundër integritetit seksual. Andaj kur janë në pyetje fëmijët, mbrojtja penalo-juridike është më e zgjeruar dhe më e fuqishme për mbrojtjen e integritetit seksual të fëmijëve.

#### **4.2 Abuzim ndaj personit të paaftë (të pafuqishëm) (neni 187 paragrafi 2)**

Në paragrafin e dytë të këtij neni parashihet dënimi i kryerësit me së paku dhjetë vjet burg nëse akti seksual i dhunshëm do të kryhet ndaj personit të pafuqishëm, në këtë rast fëmijës i cili ka mbushur 14 vjet. Fëmijët që bëjnë pjesë në këtë kategori për shkak të gjendjes së tyre të paaftë mendore dhe moshës së mitur konsiderohen si të pafuqishëm dhe si një ndër grupet më të rrezikuara të abuzimit seksual. Duke shfrytëzuar gjendjen e tyre psiko-fizike kryerësi do të veprojë me përdorimin e forcës, dhunës, apo kanosjes për të arritur qëllimet e veta.

#### **4.3 Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet (neni 188)**

Për veprën penale nga neni 188 i Kodit Penal parashihet dënim me së paku dymbëdhjetë vjet burg për atë, i cili do të kryejë akt seksual apo veprim tjetër seksual ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet. Në paragrafin (2) të këtij neni parashihet dënim me burg, së paku pesëmbëdhjetë vjet apo me burgim të përjetshëm, nëse si pasojë e veprës nga ky nen do të shkaktohet lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasoja të tjera të rënda ose vepra është kryer nga më shumë persona apo në mënyrë veçanërisht të vrazhdë ose nënçmuese. Sipas paragrafit (3) gjykata do t'i shqiptojë ndalesë kryerësit të veprës nga paragrafi (2) për të kryer profesion, veprimtari apo detyrë nën kushtet nga neni 38-b nga ky kod.

Vlen të theksohet se paragrafi (3) i këtij neni është gabim teknik që duhet të hiqet me ndryshimet e ardhshme të Kodit Penal. Shqiptimi i dënimit plotësues ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës kishte të bënte me formën e veprës, të paraqitur në paragrafin e fshirë (2) që përbëhej nga sulmi seksual i fëmijës me keqpërdorim të pozitës së

veçantë të kryerësit. Tash ky veprim është i paraparë si vepër e veçantë penale në nenin 189.<sup>86</sup>

Qëllimi i këtij neni është që të parandalojë çdo lloj akti seksual apo veprim tjetër seksual ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet, të cilët nuk janë psikikisht dhe seksualisht të pjekur për veprime të këtilla. Ky trajtim çnjerëzor mund të shkaktojë pasoja të dëmshme për zhvillimin psikik dhe fizik të personalitetit të tyre.

#### **4.4 Abuzim me keqpërdorim të pozitës (neni 189 paragrafi 2)**

Në këtë paragraf të këtij neni, vëmendje e veçantë i kushtohet mbrojtjes së fëmijëve të cilët zakonisht janë në pozitë të nënshtrimit apo varshmërisë prej familjarëve, mësimdhënësve, kujdestarëve ligjorë apo tutorëve.

Personi i afërm nga gjaku në vijë të parë ose vëlla, motër, arsimtar, edukues, adoptues, tutor, njerë, njerë, mjek apo person tjetër me keqpërdorim të pozitës së tij ose gjatë kryerjes së dhunës familjare do të kryej akt seksual ose veprim tjetër seksual me fëmijë i cili i ka mbushur 14 vjet, dhe i cili është besuar për shkak të mësimit, edukimit, ruajtjes apo kujdesit, do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.

#### **4.5 Kënaqja e epsheve seksuale para tjetrit (neni 190 paragrafi 2 dhe 3)**

Në paragrafin e (2) parashihet vepra penale e nenit 190 e cila do të kryhet nga ai i cili para fëmijës i cili ka mbushur 14 vjet bën veprim seksual apo e shtyn që para tij apo para tjetër kujt të bëjë veprim të tillë, do të dënohet me burgim prej tre deri në tetë vjet. Ndërsa në paragrafin e (3) theksohet: “ai që para fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet bën veprim seksual apo e shtyn që para tij apo para tjetër kujt të bëjë veprim të tillë, do të dënohet me së paku 4 vjet burgim”.<sup>87</sup> Në këtë nen është inkriminuar vepra e realizuar nga vet viktima. Kryerësi shtyn, nxit, apo detyron viktimën të kryejë aktin e udhëzuar seksual.

---

<sup>86</sup> Ratkoceri.V, Kastrimi kimik si sanksion penal, fq. 210, 2018

<sup>87</sup> Kodi Penal i RMV-së, neni 190 paragrafi (2) dhe (3), Gazeta Zyrtare nr.132/14

#### **4.6 Prostitucioni i fëmijëve (neni 191-a)**

Në veprën penale të prostitucionit të fëmijëve (paragrafi 1) si kryerës mund të paraqitet “ai i cili kobitë, shtyn, nxit apo mashtron fëmijën i cili ka mbushur 14 vjet në prostitucion apo ndërmjetëson, dorëzon apo merr pjesë në dorëzimin e tjetrit me qëllim të kryerjes së prostitucionit, ose i mundëson tjetrit shfrytëzim të shërbimeve të tij seksuale, apo në mënyrë tjetër e shfrytëzon për aktivitete seksuale me qëllim të përfitimit material apo përfitimit tjetër, do të dënohet me së paku katër vjet burgim”.<sup>88</sup>

Sipas paragrafit (2) kryerësi do të dënohet së paku tetë vjet burgim, në rastet kur vepra e prostitucionit të fëmijëve është kryer me përdorim të forcës apo kërcënimit serioz se do të sulmohet jeta apo trupi i fëmijës apo ndonjë të afërmi të tij. Më tej, në paragrafin (3) thuhet: nëse vepra nga neni 191-a do të kryhet ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim. Personat të cilët do të kryejnë veprat e parashikuara në paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, në kuadër të dhunës familjare, do të dënohen me së paku dhjetë vjet burgim.

Fëmijët nga të gjithë shtetet e botës janë në rrezik nga trafikimi dhe prostitucioni. Republika e Maqedonisë së Veriut është një ndër vendet që ka nënshkruar Konventën për të drejtat e fëmijëve dhe dy Protokollet e saj: Protokollin fakultativ për tregti me fëmijët, prostitucion dhe pornografi me fëmijët dhe Protokollin fakultativ për pjesëmarrjen e fëmijëve në konflikte të armatosura.

#### **4.7 Tregimi i materialeve pornografike fëmijës (neni 193)**

Me pornografi fëmijërore nënkuptohet materiali pornografik, i cili në mënyrë vizuale paraqet akte të dukshme seksuale me person të mitur ose akte të dukshme seksuale me person që duket si i/e mitur ose fotografi reale që paraqesin akte të qarta seksuale me person të mitur (neni 122 paragrafi 24).<sup>89</sup>

Në paragrafin (1) të nenit 193 konsiderohet se “ai i cili fëmijës që nuk ka mbushur 14 vjet do t’i shes, tregoj apo me shfaqje publike në mënyrë tjetër do t’i bëjë qasje në fotografi, materiale

<sup>88</sup> Kodi Penal i RMV-së, neni 191-a paragrafi (1), Gazeta Zyrtare nr.132/14

<sup>89</sup> Osmani A., Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 122 p.24, Shkup, 2015 përkthyer në gj.shqipe

audiovizuale apo të tjera me përmbajtje pornografike ose do t'i tregojë shfaqje pornografike, do të dënohet me dënim me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet”.<sup>90</sup> Kryerësi do të dënohet me burgim prej tre deri në pesë vjet, nëse vepra e lartpërmendur kryhet përmes mjeteve për informim publik (paragrafi 2). Personi që do të keqpërdor fëmijën i cili ka mbushur 14 vjet për përpunimin e fotografive audiovizuale ose materiale tjera me përmbajtje pornografike ose për shfaqje pornografike, si dhe ai që merr pjesë në shfaqjen, do të dënohet prej tre deri në pesë vjet (paragrafi 3). Për po të njëjtën vepër nga paragrafi (3) kur bëhet fjalë për fëmijën i cili nuk ka mbushur 14 vjet, kryerësi do të dënohet me së paku katër vjet burgim (paragrafi 4). Sipas paragrafit (5) personi që do të detyrojë fëmijën i cili ka mbushur 14 vjet në përpunim dhe inçizim të fotografive apo materiale tjera me përmbajtje pornografike apo për shfaqje pornografike, do të dënohet me së paku tetë vjet burgim, ndërsa në paragrafin (6) parashihet dënim me së paku dhjetë vjet burg nëse vepra nga paragrafi (5) i këtij neni është kryer ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet. Kur kryerës i veprës penale nga ky nen është personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë (paragrafi 7). Materialet nga ky nen do të merren (paragrafi 8).

#### **4.8 Prodhimi dhe distribuimi i pornografisë së fëmijëve (neni 193-a)**

Nga paragrafi i (1) theksohet dënimi i parashikuar për atë që prodhon pornografi fëmijërore me qëllim të distribuimit të saj, e transferon, apo e ofron apo në mënyrë tjetër e bën të arritshme pornografinë fëmijërore me së paku pesë vjet burgim. Ndërkaq ai që furnizohet (blen) pornografi fëmijërore për vete apo tjetrin, apo i posedon ato do të dënohet prej pesë deri në tetë vjet (paragrafi 2).

Kur vepra nga neni 191-a kryhet përmes sistemit kompjuterik apo mjet tjetër për komunikim masiv, kryerësi do të dënohet me së paku tetë vjet burgim (paragrafi 3). Personi juridik do të dënohet me dënim me gjobë nëse kryen veprën nga ky nen (paragrafi 4).

Shprehja “pornografi me fëmijët” nënkupton çfarëdo pamje vizuale apo shfaqje ose pasqyrim vizuel, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh ose fotografi e

---

<sup>90</sup> Kodi Penal i RMV-së, neni 193 paragrafi (1), Gazeta Zyrtare nr.132/14

krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyre elektronike, mekanike apo me mjete tjera, që paraqet ose pasqyron:

1. gjenitalet apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale;
2. një fëmijë të vërtetë i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar;
3. një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; ose
4. pamje realiste të një fëmije joekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar.<sup>91</sup>

#### **4.9 Mashtrim për abuzim ose veprim tjetër seksual ndaj fëmijëve të cilët nuk kanë mbushur 14 vjet (neni 193-b)**

Ky nen parasheh dënim me burg prej një deri në pesë vjet për ata të cilët përmes mjeteve komunikuese-kompjuterike me caktim të takimit apo në mënyrë tjetër mashtron fëmijën i cili nuk ka mbushur 14 vjet në marrëdhënie seksuale apo në ndonjë veprim tjetër seksual apo në prodhim të pornografisë fëmijërore dhe nëse me qëllimin e tillë është realizuar takimi i drejtpërdrejtë me të miturin.

Në vitin 2015 në Shkup në bashkëpunim të Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Metamorfozis, Fondacionit për internet dhe shoqëri, si dhe shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit, si pjesë e projektit “ORË PËR PRIVATËSINË” është krijuar një Udhëzues për prindër për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të fëmijëve në internet. Qëllimi i këtij udhëzimi është kontribuojë në ngritjen e vetëdijes për atë se si funksionojnë teknologjitë e reja, si të mbrojnë prindërit fëmijët e tyre nga qasja në përmbajtje dhe komunikime të papërshtatshme.

Në udhëzuesin e lartpërmendur personat të cilët mund të mashtrojnë fëmijët nëpërmjet mjeteve komunikuese-kompjuterike në marrëdhënie seksuale (në takim) apo në ndonjë veprim tjetër seksual apo në prodhim të pornografisë fëmijërore janë emëruar si “online grabitqarët”.

Online grabitqarët mund të përpiqen t’i mashtrojnë fëmijët dhe adoleshentët në biseda

---

<sup>91</sup> Salihu.I, Zhitija.H, Hasani.F, Komentar i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014



seksuale, madje të kërkojnë edhe takime personale. Grabitqarët ndonjëherë dërgojnë porosi me përmbajtje të papërshtatshme ose kërkojnë nga fëmijët që t'u dërgojnë fotografi. Prandaj, është me rëndësi t'i mësoni fëmijët tuaj që gjithmonë të kenë kujdes kur janë online. Adoleshentët janë në përgjithësi në rrezik më të madh nga online grabitqarët, pasi që janë kureshtarë dhe duan të jenë të pranueshëm, ata mund të bisedojnë vullnetarisht me grabitqarë, madje edhe nëse e dinë se është e rrezikshme. Ndonjëherë ata mund të besojnë se janë të dashuruar tek dikush online, duke i rritur kështu gjasat që të pajtohen të dalin në takim ballë për ballë me dikë.<sup>92</sup>

Duke iu bashkangjitur shënimit të ditës evropiane për internet më të sigurt dhe në bazë të nenin 68 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në seancën e mbajtur më 1 mars 2010, miratoi: **Deklaratën për internet më të sigurt.**<sup>93</sup>

#### **4.10 Incesti (neni 194 paragrafi 2)**

Sipas paragrafit (2) kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim nëse vepra nga ky nen është kryer me fëmijë i cili nuk i ka mbushur 14 vjet.

Definuar sipas perspektivës psiko-sociale, incesti përfshin çdo formë të marrëdhënies seksuale ndërmjet fëmijës dhe prindërve, njerëzve apo ndonjë anëtar tjetër i familjes (gjyshërit, halla/teze, daja/xhaxhai). Me fjalë të tjera incesti paraqet marrëdhëniet seksuale ndërmjet anëtarëve në familje.<sup>94</sup> Si arsye e inkriminimit të kësaj vepre është cënimi i moralit familjar, çrregullimi i marrëdhënieve familjare, si dhe shkaktohen pasoja negative në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Kryes i kësaj vepre mund të jetë vetëm i afërm i gjakut në vijë të drejtë, ndërsa në vijë të tërthortëe motra ose vëllai.<sup>95</sup>

---

<sup>92</sup> Udhëzues për prindër për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të fëmijëve në internet, 2015, Shkup <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2015/06/udh%C3%ABzuesi-31.pdf>

<sup>93</sup> Deklaratë për internet më të sigurt, neni 68 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë

<sup>94</sup> Sgroi, Suzanne M., Handbook of clinical intervention in child sexual abuse, Canada, 1989

<sup>95</sup> Salihu. I, E drejta penale (pjesa e posaçme), 2006, Prishtinë

#### 4.11 Tregti me fëmijë (neni 418-g)

Sipas paragrafit (1) të këtij neni “Ai i cili do të shtyjë fëmijën në kryerje të veprimeve seksuale apo do të mundësoj kryerje të veprimeve seksuale me fëmijë apo do të rekrutojë, transportojë, bartë, blen, shet, strehon apo pranon fëmijë me qëllim të eksploatimit dhe përdorimit të tij për aktivitete seksuale për kompensim parash apo kompensim tjetër apo forma tjera të eksploatimit seksual, pornografisë, punës së detyrshme apo dhunimit, robërimit, martesave të dhunshme, fertilizimit të dhunshëm, adoptimit joligjor apo ofrimi i pajtimit si ndërmjetësues që të adoptohet fëmijë, transplantim i paligjshëm i organeve të trupit të njeriut, do të dënohet me së paku tetë vjet burgim”.<sup>96</sup> Ndërsa për kryerësin nga paragrafi (2) dënimi do të jetë me së paku dhjetë vjet burg nëse personi veprën nga paragrafi (1) do ta kryejë me dhunë, kërcënim serioz, me mashtrim apo formë tjetër të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, me keqpërdorim të pozitës së vet apo pozitës së shtatzënisë, pamundësisë apo paaftësisë fizike apo psiqike të tjetrit, apo me dhënien apo marrjen e të hollave apo dobi tjetër që të merr pëlqimin e personit i cili ka kontrollin ndaj personit tjetër. Në vazhdim kryerësi në paragrafin (3) të këtij neni do të dënohet me së paku tetë vjet burgim në rast se shfrytëzon apo i mundëson tjetrit shfrytëzimin e shërbimeve seksuale apo lloj tjetër të eksploatimit nga personi i mitur për të cilin ka ditur apo ka qenë i obliguar të dij se është viktimë e tregtisë me njerëz. Në paragrafin (4) parashihet dënim për atë i cili do të marr apo prish letërnjoftimin, pasaportë apo ndonjë dokument tjetër të huaj të identifikimit për të kryer veprën nga ky nen, me burg për së paku katër vjet burgim.

Kur tregtia me fëmijë do të realizohet nga personi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim (paragrafi 5). Në paragrafin (6) theksohet se pranimi i personit të mitur me veprimet e parapara në paragrafin (1) nuk është me rëndësi për ekzistimin e veprës penale nga paragrafi (1). Personi juridik do të dënohet me dënim me gjobë nëse kryen veprën penale të këtij neni (paragrafi 7). Paluajtshmëritë të shfrytëzuara, sendet dhe mjetet transportuese të përdorura për kryerjen e veprës penale do të merren (paragrafi 8).

Vetë emërtimi “trafikimi me njerëz” tregon se me këtë vepër penale bëhet tregti me njerëz, bëhet shitblerja e njerëzve dhe se qëllimi kryesor është realizimi i dobisë pasurore. Trafikimi me

---

<sup>96</sup> Kodi Penal i RMV-së, neni 418-g paragrafi (1), Gazeta Zyrtare nr.132/14

njerëz është paraparë si vepër penale me një numër relativisht të madh të konventave ndërkombëtare. Konventat më të rëndësishme ndërkombëtare me të cilat ndalohet dhe ndëshkohet trafikimi me njerëz janë: Konventa mbi ndalimin e tregtisë me robër të bardhë të vitit 1910; Konventa për ndëshkimin e tregtisë me gra dhe fëmijë të vitit 1921; Konventa për ndëshkimin e tregtisë me gra të rritura, të moshës madhore të vitit 1933; Konventa për ndëshkimin dhe parandalimin e tregtisë me njerëz dhe eksploatimin e tyre për qëllime prostitucioni të vitit 1949 dhe Konventa për parandalimin e tregtisë me njerëz dhe eksploatimi i të tjerëve të vitit 1950.<sup>97</sup>

## **5. Regjistri dhe cënimi i të drejtave të njeriut për kryerësit**

Duke pasur parasysh efektin pozitiv preventiv të këtij regjistri të hapur, gjithmonë kanë ekzistuar edhe kritika të shumta si në SHBA ashtu edhe në RMV. Rastet të cilat shpesh herë dështojnë në regjistrimin e kryerësve janë rastet e incestit, të cilat rrallë denoncohen dhe shënojnë rezultate negative të regjistrimit. Në situata të tilla roli i programeve preventive në procesin edukativ-arsimor është i domosdoshëm, nëpërmjet të cilit fëmijët do të informohen në lidhje me rrezikun që mund të ballafaqohen si dhe do të aftësohen për të denoncuar raste të këtij lloji. Një nga kritikantët më të diskutuara për regjistrimin abuzuesve ishte ajo e publikimit të të dhënave personale kryesore të abuzuesve seksual (emri, mbiemri, vendi, adresa dhe fotografia). Kundërshtuesit e këtij regjistri arsyetohen me atë se regjistri shkel të drejtat dhe liritë themelore të kryerësit, të drejtën e privatësisë dhe intimitetit, të drejtën për të mbrojtur burimin e informacionit në mjetet e informimit, dëmtonin familjen e tyre, kufizojnë të drejtat e tyre pas vuajtjes së dënimit, si dhe është në kundërshtim me Kushtetutën.

Iniciativë për kundërshtimin e Regjistrimit u shtrua edhe para Gjykatës Kushtetuese në RMV, ashtu që në maj të vitit 2013 u mbajt procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafët 2 dhe 3, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit për regjistrin e veçantë të personave të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë. A.S, V.B, Z.L, K.Z, dhe D.I, të gjithë të dënuar në burgun e Tetovës kanë paraqitur një iniciativë kundër publikimit të të dhënave në regjistër, katër nga të cilët ishin të dënuar për veprën penale nga neni 418-g “Tregti me fëmijë” të Kodit Penal, që të katërit ishin prindër.

---

<sup>97</sup> Kambovski.V, Komentar na Krivicniot Zakonik na Republika Makedonija, 2015, Skopje

Sipas këtyre të dënuarve, publikimi i të dhënave të tyre personale, në përputhje me nenin 5 të ligjit, përbënte një shkelje flagrante të lirive dhe të drejtave të tyre themelore të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Fakti që çdo qytetar kishte qasje të lirë në internet përmes faqes [www.registarnapedofili.mk](http://www.registarnapedofili.mk) dhe rrjetit social [www.facebook.com Stop.Pedofilija.mk](http://www.facebook.com/Stop.Pedofilija.mk), bëri të mundur zbulimin e dënimit dhe të dhënave të tyre personale, të cilat në mënyrë flagrante shkelnin privatësinë dhe intimitetin e tyre, si dhe fshehtësinë e garantuar të të dhënave të tyre personale dhe familjare.

Ato pohojnë se Ligji në tërësi, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 6, nenin 18 paragrafët 1 dhe 2, nenin 25 dhe nenin 51 të Kushtetutës, të cilat garantonin të drejtën për të mbrojtur burimin e informacionit në mjetet e informimit, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, mbrojtjen kundër cënimit të integritetit personal dhe respektimin dhe mbrojtjen e privatësisë të jetës së tyre personale dhe familjare. Ligji i kontestuar ishte gjithashtu në kundërshtim me nenin 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili garantonte respektimin e jetës private dhe familjare.

Bazuar në analizën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, aktet ndërkombëtare dhe pikëpamjet krahasuese, Gjykata Kushtetuese<sup>98</sup> theksoi se Ligji për Regjistrin e Veçantë të Personave të Dënuar për vepër penale të abuzimit seksual të të miturve dhe pedofilisë në tërësi, është në përputhje me nenin 18 paragrafët (1) dhe (2), nenin 25 dhe nenin 51 të Kushtetutës. Ndërsa procedura për vërtetimin e kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafët (2) dhe (3), nenit 10 dhe nenit 11 të ligjit për Regjistrin e veçantë duhet të shqyrtohet dhe se paraqet problematikë serioze në përputhshmërinë me Kushtetutën e RMV. Sipas Gjykatës Kushtetuese në përputhje me rrethanat, shteti duhet të gjejë mekanizma të tjera për të eliminuar këtë dukuri negative në shoqëri.

Ky vendim ishte i vitit 2013, ndërsa ndryshimi i Ligjit për Regjistrin u bë në vitin 2014, në bazë të të cilit nuk u bë asnjë ndryshim për nenet kontestuese por të njëjtat u plotësuan si dhe u bë specifikimi dhe qartësimi në lidhje me procedurën e futjes të të dhënave si dhe institucioneve kompetente përgjegjëse në lidhje me këtë temë.

---

<sup>98</sup> Y.6p.86/2012, Vendim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, <http://ustavensud.mk/?p=10995>

Sipas të dhënave nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale<sup>99</sup> sot e kësaj dite ky Regjistër është në funksion, ndërsa vendimi i gjykatës nuk është marrë parasysh nga Parlamenti dhe është konsideruar vetëm si një mendim i dhënë nga Gjykata Kushtetuese.

Kur bëhet fjalë për abuzuesit e veprave penale të këtij lloji disa persona shprehin keqardhje për to, se do të urrehen nga shoqëria, do t'ju shkaktohet dhunë apo malltretim, do t'ju shkelet e drejta e privatësisë dhe do të dëmtohen edhe familjet e tyre. Në fakt guximi i të dënuarve të cilët inicuan këtë procedurë është i tmerrshëm kur merret parasysh pala e dëmtuar, gjendja e tyre dhe familjarët e tyre. Pas veprave të tilla pikë fokusi duhet të jetë e drejta e viktimës mbrojtja e saj, rehabilitimi dhe riintegrimi, si dhe dënimi maksimal i paraparë për kryerësit. Favorizimi duhet të anojë nga ana e dëmtuar duke pasur parasysh lëndimin emocional, fizik dhe psikologjik të fëmijëve, e të mos merren parasysh rrethanat të cilat do të ulin dënimin e kryerësit.

---

<sup>99</sup> Todorevska.E, Ministria e punës dhe politikës sociale - Departamenti për mbrojtje shoqërore-familjare dhe juridike të fëmijëve dhe familjes

Фотографија 1. Ballina e web-faqes së Regjistrit të pedofilëve në RMV



**СТОП за ПЕДОФИЛИЈА**

**Регистар за лица осудени за кривични дела за сексуална злоупотреба на малолетни лица и педофилија**

<b>ПОЧЕТНА</b> <small>ПОЧЕТНА СТРАНА</small>	<b>ПРЕБАРАЈ</b> <small>ПРЕБАРУВАЊЕ</small>	<b>ПРАШАЊА</b> <small>ПРАШАЊА И ОДГОВОРИ</small>	<b>ПРЕВЕНЦИЈА</b> <small>ЕДУКАЦИЈА И ПРВЕНЦИЈА</small>
---	---	---	---

-  почетна
-  пребарај
-  превенција
-  прашања



Група на FB:  
[www.facebook.com/Stop.pedofilija](http://www.facebook.com/Stop.pedofilija)  
 Профил на FB:  
[www.facebook.com/Stop.Pedofilija.MK](http://www.facebook.com/Stop.Pedofilija.MK)  
 За прашања :  
[pedofilija@zsd.gov.mk](mailto:pedofilija@zsd.gov.mk)

**Добредојдовте** на нашата страна

Посебниот регистар за лица осудени со правосилна пресуда за кривични дела за сексуална злоупотреба на малолетни лица и педофилија, координиран од страна на Министерството за труд и социјална политика на Република Македонија, кој се води во ЈУ Завод за социјални дејности – Скопје, овозможува пристап до одредени информации за сите осуденици за овие кривични дела. Оваа страна преку едноставно пребарување на крајниот корисник му овозможува пристап до листа на сите осудени лица за кривични дела за сексуална злоупотреба на малолетни лица и педофилија во која се содржани податоци за населеното место, општината и улицата на која живеат овие лица. Исто така, обезбедени се и информации со цел превенција на педофилијата, како и линкови кои би ги збогатиле Вашите знаења за начините како би можело ваквото злосторство да се спречи .

**Услуги кои ги нудиме**

**Почетна** Оваа веб страна обезбедува едноставно пребарување на лица осудувани за педофилија , дава информации како да се справиме и да ја превенираме педофилијата.

**Пребарување** Постои можност за пребарување на лица осудувани за педофилија по име , презиме, место на живеење и улица.

**Прашања и одговори** Нуди одговор на најчесто поставувани прашања кои се поврзани со педофилијата

**Превенција и едукација** Дава едноставни пораки кои ќе ве едуцираат како можете да ја превенирате педофилијата

**15 505**

**ПРИЈАВИ**

## Kapitulli IV

### Studim empirik

#### **1. Të dhënat statistikore në Regjistrin për persona të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV për periudhën 2012-2018**

Me ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal në vitin 2011 (Gazeta Zyrtare nr.51/11) në vazhdim të nenit 106 shtohet nen i ri 106-a me titull “Regjistri i veçantë” ku në paragrafin e dytë përcaktohet: “Gjykata deri te organi i administratës shtetërore kompetente për punët në fushën e punës dhe politikës sociale dorëzon të dhëna për persona të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor dhe për veprën penale nga neni 418-g i këtij kodi të kryera kundër personave të mitur, për të cilët mbahet (krijohet) një regjistër i posaçëm”.<sup>100</sup> Sipas paragrafit të tretë, qëllimi për ekzistimin e këtij regjistri është mbrojtja e të drejtave të personave të mitur, nën kushtet dhe në procedurën e përcaktuar me ligj.

Të dhënat e publikuara në Regjistrin e veçantë janë të dhëna kryesore për personat e dënuar me aktgjykim të formës së prerë, gjegjësisht: emri, mbiemri dhe pseudonimi, data e lindjes, adresa e vendbanimit ose vendbanimi, vepra penale për të cilën janë dënuar, lartësia e dënimit, fillimi, përfundimi ose ndryshimi i dënimit me burg si dhe fotografi. Në vazhdim, nëpërmjet tabelave do të pasqyrojmë të dhënat e nxjerra nga Regjistri për llojin e veprës penale, të dhënat rreth vendbanimit të kryerësve, të dhënat gjinore dhe llojet e dënimeve të shqiptuara ndaj kryerësve. Këto të dhëna janë siguruar nëpërmjet qasjes së drejtpërdrejtë në web portalin online të Regjistrit.

#### **1.1 Lloji i veprës penale**

Veprat penale të përfshira në Regjistër janë të inkriminuara në kapitullin e nëntëmbëdhjetë të Kodit Penal, “Veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor”, si dhe neni 418-g i përfshirë në kapitullin tridhjetëedy, “Veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare”.

---

<sup>100</sup> Kodi Penal i RM-së, neni 106-a, Gazeta Zyrtare nr.51/11

Në Tabelën 1. kemi paraqitur llojet e veprave penale, të cilat janë përfshirë në Regjistër, si dhe numrin e veprave të kryera.

**Tabela 3: Llojet e veprave penale të përfshira në “Regjistrin e Veçantë” (Kodi Penal nenet 186-194 dhe neni 418-g)**

Llojet e veprave penale të përfshira në Regjistër		Numri i veprave të përfshira në Regjistër
1.	Dhunimi (neni 186 paragrafi 2)	7
2.	Abuzim ndaj personit të paaftë (të pafuqishëm) (neni 187 paragrafi 2)	3
3.	Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet (neni 188)	166
4.	Abuzim me keqpërdorim të pozitës (neni 189 paragrafi 2)	8
5.	Kënaqja e epsheve seksuale para tjetrit (neni 190 paragrafi 2 dhe 3)	7
6.	Prostitucioni i fëmijëve (neni 191-a)	/
7.	Shtytje dhe mundësim i akteve seksuale (neni 192)	5
8.	Tregimi i materialeve pornografike fëmijës (neni 193)	12
9.	Prodhim dhe distribuimi pornografisë së fëmijëve (neni 193-a)	2
10.	Mashtrim për abuzim ose veprim tjetër seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet (neni 193-b)	1
11.	Incesti (neni 194 paragrafi 2)	9
12.	Tregti me fëmijë (neni 418-g)	46
Gjithësej:		266

Në tabelën e paraqitur më lartë mund të vërejmë se vepra penale e cila paraqet numër më të madh të kryerësve është vepra nga neni 188 “Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet”, me 166 raste. Më tej kemi veprën “Tregti me fëmijë” nga neni 418-g me 46 raste. “Tregimi i materialeve pornografike fëmijës” (neni 193) me 12 raste. Në vijim kemi 9 raste të veprës së “Incestit” të nenit 194 paragrafi i (2), si një nga veprat më të rënda dhe më rrallë të



raportuara në shoqëri. Në nenin 189 paragrafi (2) “Abuzim me keqpërdorim të pozitës” kemi të paraqitur 8 kryerës, të cilët janë të caktuar apo të besuar për t’u kujdesur për fëmijën. Me nga 7 kryerës janë të shfaqura veprat penale nga neni 186 paragrafi (2) “Dhunimi” dhe neni 190 paragrafi (2) dhe (3) “Kënaqja e epsheve seksuale para tjetrit”. Vlen të përmendet se vepra me 5 kryerës “Shtytje dhe mundësim i akteve seksuale” (neni 192), është hequr nga Kodi Penal me ndryshimet e vitit 2014. Abuzim ndaj personit të paaftë (të pafuqishëm) (neni 187 paragrafi 2) kanë kryer 3 persona. Veprat me numër më të vogël të kryerësve janë “Prodhim dhe distribuimi pornografisë së fëmijëve” (neni 193-a) me dy kryerës dhe “Mashttrim për abuzim ose veprim tjetër seksual ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet” (neni 193-b) me 1 kryerës, ndërsa në nenin 191-a “Prostitucioni i fëmijëve” nuk ka të dhëna për ndonjë rast të kryer.

Nga të dhënat e paraqitura më lart vërejmë se numri i veprave penale në Regjistrin e veçantë që nga viti 2012 deri në vitin 2020 është 266. Meqenëse, numri i kryerësve në Regjistër është 251, 13 kryerës janë të dënuar për kryerje të dy veprave penale, ndërsa deri më tani vetëm 1 kryerës është i dënuar për tre vepra penale.

## **1.2 Të dhënat gjinore**

Abuzuesit seksual të fëmijëve të cilët dominojnë në të gjithë vendet e botës janë kryerësit e gjinisë mashkullore. Edhe në RMV, sipas analizës së Entit për punë sociale, nga 248 kryerës të abuzimit seksual të regjistruar në Regjistër deri në vitin 2018, janë të gjinisë mashkullore, pra 237 kryerës ose (95.5%). Ndërsa deri në vitin 2018 kemi vetëm 11 kryerëse femra apo 4.5%, që shpesh janë bashkëpunëtore dhe ndihmëse të meshkujve, e jo kryerës të drejtpërdrejtë. Të dhënat nga Regjistri tregojnë se gjatë 3 viteve të fundit nuk ka pasur kryerës të gjinisë femërore.

**Tabela 4: Të dhënat e kryerësve në Regjistër sipas gjinisë**

	n.186 prg.2	n.187 prg.2	n.188	n.189 prg.2	n.190 prg.2,3	n.191-a	n.192	n.193	n.193-a	n.193-b	n.194 prg.2	n.418-g
<b>M</b>	7	3	165	8	7	0	2	11	2	1	9	40
<b>F</b>	0	0	1	0	0	0	4	1	0	0	0	6
<b>Gj.</b>	7	3	166	8	7	0	6	12	2	1	9	46

Të dhënat na tregojnë dukshëm dallimin e madh të numrit të veprave të kryera nga meshkujt në krahasim me femrat. Në Regjistër janë të paraqitur gjithësej 251 kryerës, prej të cilëve 240 janë gjinisë mashkullore dhe vetëm 11 të gjinisë femërore.

Numri më i madh i veprave të kryera nga meshkujt është vepra nga neni 188 “Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet” dhe vepra nga neni 418-g që ka të bëjë me “Tregti me fëmijë”. Ndërsa femrat më shpesh paraqiten si kryerëse të veprave nga neni 418-g “Tregti me fëmijë” dhe vepra tashmë e fshirë nga neni 192 “Shtytje dhe mundësim i akteve seksuale”.

Duke u bazuar në të dhënat e nxjerra, është e rëndësishme të theksohet se kryerësit potencial janë të të gjithë moshave. Kryerësit më dominues janë të ndarë në dy kategori të grupmoshave: 18-24 vjet dhe 31-40 vjet. Por nuk duhet anashkaluar faktin që 16 autorë, në kohën e krimit kanë qenë mbi 60 vjeç. Kryerësi më i vjetër i regjistruar është Zh.G, i vitit 1934, për veprën nga neni 188 “Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet”, i cili në momentin e kryerjes së veprës ka pasur 73 vjet. Ndërsa kryerësi më i ri është I.I, i vitit 1996, për veprën nga neni 186 paragrafi (2) “Dhunim”, i cili në momentin e kryerjes së veprës rezulton të ketë pasur 21 vjet.

### **1.3 Të dhënat rreth vendbanimit të kryerësve**

Abuzimi seksual i fëmijëve dhe veprimet e ngjajshme janë pjesë e çdo vendbanimi në RMV. Diku me një numër të madh të kryerësve, e diku me numër jashtzakonisht të ulët. Krahas kësaj duhet përmendur fakti se në disa vende shoqëria është më e vetdijësuar dhe më tendecioze në lidhje me denoncimin e rasteve të tilla, ndërsa në anën tjetër kemi vendet ku kjo temë njihet si tabu dhe numri i denoncimeve është relativisht i ulët.

Në vijim do të paraqesim numrin e kryerësve të regjistruar sipas vendbanimit të tyre, duke filluar me komunat nga rajoni i qytetit të Shkupit, me një numër më të madh kryerësve. Që nga viti 2012 e deri më sot në qytetin e Shkupit janë të regjistruar 46 kryerës. Prej të cilëve 44 janë meshkuj dhe vetëm 2 janë femra. Të regjistruarit janë kryerës të veprave të ndryshme të parashikuara në Ligjin e Regjistrimit për pedofilë.

**Tabela 5: Të dënuarit e regjistruar në qytetin e Shkupit**

Aerodrom	Butel	G.Babë	Gj.Petrov	Karposh	K.Vodë	Saraj	Qendër	Çair	Sh.Orizar
3	4	9	3	1	2	4	3	7	10

Pas qytetit të Shkupit, në gjendje alarmuese është qyteti i Gostivarit me 18 kryerës, prej të cilëve 16 janë meshkuj dhe 2 janë femra. Më tej kemi qytetin e Prilepit me 15 kryerës, në mesin e të cilëve kemi edhe 1 femër si kryerëse. Qyteti i Velesit ka 14 kryerës të regjistruar me 2 kryerëse të gjinisë femërore, Manastiri dhe Kumanova kanë nga 12 kryerës, Shtipi ka 11 kryerës me 2 kryerës të gjinisë femërore, si dhe Strumica me 10 kryerës nga të cilët 1 kryerëse është femër. Qyteti i Koçanit ka 8 kryerës të regjistruar, ndërsa në Kërçovë janë 7 kryerës.

**Tabela 6: Qytetet me numër më të madh të dënuarve**

Gostivar	Prilep	Veles	Manastir	Kumanovë	Shtip	Strumicë	Koçan	Kërçovë
18	15	14	12	12	11	10	8	7

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur qytetet të cilat kanë një numër mesatar të kryerësve. Qyteti i Delçevës, Ohrit dhe Negotinës kanë nga 6 kryerës. Dibra, Kriva Pallanka dhe Sveti Nikollë kanë nga 5 kryerës. Ndërkaq Vinica, Gjevgjelia, Kavadari dhe Tetova kanë nga 4 kryerës.

**Tabela 7: Qytetet me numër mesatar të dënuarve**


Delçevë	Ohër	Negotinë	Dibër	K.Pallankë	S.Nikollë	Vinicë	Gjevgjeli	Kavadar	Tetovë
6	6	6	5	5	5	4	4	4	4

Vendbanimet me më pak kryerës janë Zhelina, Zrnovci, Llozova, Probishtipi, Radovishi, Studeniçani me nga 3 kryerës. Bogdanci, Bosilova, Vasileva, Dollneni, Makedonska Kamenica, Pllasanica, Sopsishti, Çashka janë vendet me nga 2 kryerës. Vendbanimet të cilat kanë nga 1 kryerës të regjistruar janë: Berova, Bërvenica, Demir Hisari, Ilindeni, Karbinci, Mavrovë Rostushe-Leunovë, Makedonski Brod, Oslomej, Petrovec, Rankovec, Rosoman, Staro Nagoriçan, Stuga dhe Tearca. Njëkohësisht është e rëndësishme të përmendet se në RMV janë rreth 27 komuna të cilat nuk kanë të regjistruar asnjë rast të abuzimit seksual të fëmijëve. Kjo nuk do të thotë se në ato vende nuk ka raste të tilla, miëpo fatkeqësisht ka raste të cilat nuk denoncohen si dhe mbeten të pa identifikuar nga prindërit, personat të cilët merren me fëmijë, institucionet edukative-arsimore apo spitalet.

#### 1.4 Llojet e dënimeve të shqiptuara ndaj kryerësve

Sistemi i dënimeve në RMV për personat kryerës të abuzimit seksual të fëmijëve është ndryshuar vazhdimisht. Me ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2014 u ndryshuan dhe u rritën dënimet për këto kryerës. Në vazhdim nëpërmjet tabelës do të paraqesim dënimet e personave të regjistruar në Regjistrin e pedofilëve.

**Grafiku 1:** Llojet e dënimeve të shqiptuara ndaj kryerësve



Nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore të siguruara nga Regjistri mund të vërejmë numrin e madh të dënimeve me burg për periudhën kohore 4 vjeçare. Duke u bazuar në të dhënat shohim se 57 kryerës janë të dënuar me 4 vite burg. Kryesisht këto dënime janë shqiptuar ndaj të gjitha llojeve të veprave penale të cilat pengojnë zhvillimin psikik dhe fizik të fëmijëve. Për veprat penale të abuzimit seksual të fëmijëve, të cilat dëmtojnë fëmijët, ky lloj dënimi me burgim për 4 vite është mjaft shqetësues. Megjithëse pas reagimeve dhe komenteve të shumta revoltuese nga ana e Ambasadës së parë për mbrojtjen e fëmijëve (MEGJASHI) organizatave tjera joqeveritare, profesionistëve, ekspertëve dhe qytetarëve, në vitin 2014 në Kodin Penal u vendosën dënime më të ashpra, shqiptimi i tyre në raste të tilla është i rallë.

Në vazhdim kemi numër të njejtë të kryerësve të dënuar me burgim për 5 dhe për 8 vjet, respektivisht 30 kryerës me burg për 5 vjet dhe 30 kryerës me burg për 8 vjet. Dënimi me burg për 6 vite është caktuar për 25 persona, ndërsa për 19 persona është caktuar burgim për 10 vite. Të dënuar me burg për 2 vjet dhe 7 vjet kemi nga 13 persona. Nga 10 persona kemi të dënuar për 9 dhe 12 vjet burg. Kryerësit e dënuar me 11 vjet burg janë 8, në të njejtën kohë kemi 8 kryerës për dënimin me 3 vjet burg. Me burg për 15 vjet kemi 7 kryerës, për 14 vjet kemi 5 kryerës, si dhe 2 kryerës të dënuar për 16 vite burg. Dënim me 2 vite burg janë caktuar 13 kryerësve dhe 1 vit burg për 5 kryerës.

Dënimet në regjistër shpesh janë të shprehura edhe në vite e muaj (p.sh 10 vite e 6 muaj), mirëpo në të dhënat në grafik kemi rrumbullaksuar numrin e muajve duke u bazuar në vitin e caktuar. Dy persona janë të dënuar me 6 muaj burg për veprën penale nga neni 193 “Tregimi i materialeve pornografike fëmijës” dhe një i dënuar me 9 muaj për veprën penale nga i njëjti nen. Ndërkaq një person është dënuar me 6 muaj dhe një tjetër për 7 muaj për veprën penale nga neni 188 “Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet”, që të dy të dënuar para vitit të ndryshimeve të Kodit Penal (dënimi minimal që parashihet sot për këtë vepër është 12 vjet). Ndërsa për një person nuk ka të dhëna për dënimin, kryerës i veprës nga neni 188.

Dënim për 20 vjet burg është shqiptuar në vitin 2018 për personin B.I. nga Saraj, për veprën nga neni 188 “Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet” dhe për veprën “Abuzim me keqpërdorim të pozitës”, neni 189 paragrafi 2.

Dënimi më i lartë në RMV për veprat e abuzimit seksual të fëmijëve është dënimi i shqiptuar me burg të përjetshëm. Konkretisht bëhet fjalë për Z.K., tashmë i moshës 52 vjeçare nga Manastiri, i dënuar për veprën penale nga neni 188 “Sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet”. Ai u kap në vitin 2013 dhe sipas shkrimeve të medieve në atë vit Z.K. dyshohej se kishte përdhunuar dy të mitur të moshës 8 dhe 11 vjeçare në banesën e tij si dhe për një periudhë kishte kryer veprime të turpshme para të miturve prej 8 deri 15 vjet në oborret e shkollave.<sup>101</sup>

---

<sup>101</sup> Ratkoceri.V, Regjistri i pedofilisë në Republikën e Maqedonisë, Konferenca e parë shkencore e studentëve të fakultetit të drejtësisë në UEJL, Tetovë, 2017

## Përfundim dhe rekomandime

Vitet e para të jetës janë vitet formuese në jetën e fëmijëve. Periudha e fëmijërisë paraqet një ndër fazat delikate të zhvillimit psikik dhe fizik të fëmijëve. Abuzimi seksual i fëmijëve është një nga format më të rënda të abuzimit ndaj fëmijëve dhe paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të drejtave të tyre. Pasojat e abuzimit seksual janë mjaft shqetësuese mund të rezultojnë me vështirësi në të mësuarit, aftësi të kufizuara sociale, ka gjasa për të shfaqur sjellje të rrezikshme ose kriminale, depresion ose shenja ankthi, vetvrasje, etj. Pasojat e tilla mund të shfaqen edhe në fazat e mëvonshme të jetës si të rritur në trishtim dhe dhimbje të fshehur.

Në rradhë të parë prindërit dhe edukatorët, shoqëria dhe institucionet shtetërore duhet të kontribuojnë në jetën e fëmijës në një mjedis të sigurt dhe mirëqenien e tyre. Fatkeqësisht ekzistojnë raste ku si kryerës i abuzimit seksual është person i familjes së afërt apo dikush i njohur nga familja. Në këto raste fëmijët manipulohen nga të dashurit e tyre, kërcënohen apo frikësohen me qëllim të mos tregojnë sekretin mes tyre. Ndër kërcënimet më të shpeshta për mosdenoncimin e abuzimit janë: frika nga hakmarrja, stigmatizimi dhe turpi, mungesa e mbështetjes, shkatërrimi i familjeve, vrasja, etj. Shumica e fëmijëve viktimë të abuzimit seksual mendojnë se ata janë shkaktarët e tij apo e perceptojnë abuzimin si një formë ndëshkimi për një faj të vetin.

Edhe pse Republika e Maqedonisë së Veriut është një shtet me territor dhe numër të popullsisë relativisht të vogël numri i kryerësve të veprave penale të abuzimit seksual të fëmijëve është çdo ditë në rritje. Nisur nga efekte të tilla paralajmëruese të rrezikut, parandalimi i keqtrajtimit të fëmijës duhet të bëhet prioritet.

Shteti ynë ka ndërmarrë disa masa në lidhje me parandalimin e kësaj dukurie si dhe masa ndihmëse të personave veç më viktimë të abuzimit seksual, si: plan veprime, programe, protokolle, standarde dhe norma për parandalim, mbrojtje dhe trajtim të fëmijëve viktimë të abuzimit, ka miratuar ligje të ndryshme dhe konventa që kanë të bëjnë me këtë temë. Mirëpo disa prej tyre nuk janë menaxhuar si duhet, kanë mbaruar afatin e fuqizimit, apo janë zbatuar vetëm përkohësisht. Në vazhdim do të përmendim disa prej tyre: Ligji për të drejtat e të miturve, Ligji për drejtësi të fëmijëve, Ligji për regjistrin e veçantë të personave të dënuar për vepra penale për abuzim seksual të personave të mitur dhe pedofili, Procedura standarde

operative për trajtimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, Plan veprimi nacional për luftë kundër trafikimit me Qenie njerëzore për periudhën kohore 2009-2012, Plan veprimi për parandalimin dhe luftimin e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë 2009-2012, Programi për risocializimin dhe riintegrimin e fëmijëve-viktima të trafikimit me qenie njerëzore, Protokollin për bashkëpunim ndërmjet institucioneve kompetente në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë.

Regjistri i veçantë për personat e dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të personave të mitur dhe pedofili ka për qëllim parandalues dhe mbrojtjen e fëmijëve nga ky fenomen. Edhe pse ka pasur ankesa dhe tendenca për mbylljen e këtij Regjistri, me arsyen se cënon të drejtat private të kryerësve, ky regjistër është ende në funksion. Duke u bazuar në faktin se vet kryerësit kanë shkatëruar të ardhmen e shumë fëmijëve, nuk duhet të merret parasysh një iniciativë e tillë.

Recidivizmi i veprave penale paraqet një rrezik serioz për sigurinë publike. Sipas hipotezës ndihmëse “Regjistri për persona të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili në RMV është i domosdoshëm për të penguar recidivizmin e kryerësve”, SHBA-ja ishte vendi i parë në botë që pa të nevojshme krijimin dhe publikimin e Regjistrin të tillë. Pas ratit të Megan Kanka, e cila u dhunua dhe u vra nga një fqinj i cili ishte dënuar dy herë si abuzues seksual. Legjislatorët në SHBA krijuan Regjistrin e abuzuesve seksual dhe Ligjin e Megan me qëllim që të mbrojnë komunitetet, dhe fëmijët në veçanti. Qëllimi i Regjistrin ishte që prindërit të njiheshin me abuzuesit seksual të fëmijëve dhe të jenë të kujdesshëm se në përkujdesjen e kujt e lënë fëmijën. Përveç Regjistrin të publikuar RMV në vitin 2014 inkorporoi kastrimin kimik në legjislacionin e saj penal, me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve nga kryerësit recidivist pas daljes nga burgu dhe të cilët vuajnë nga parafilia.

Dënimet për kryerësit e këtyre veprave penale janë precize dhe mjaft mirë të inkrimuara në Kodin Penal duke pasur parasysh llojin e veprës, mënyrën e kryerjes, qëllimin dhe pasojat e viktimës. Mirëpo gjatë analizimit të dënimeve në Regjistrin e veçantë pjesa më e madhe e dënimeve të shqiptuara për autorët e krimeve janë të lehta në krahasim me dënimet e parapara. Në rastet e abuzimit seksual të fëmijëve (tregtisë së fëmijëve apo vepra të tjera të tilla) favorizimi duhet të anojë nga ana e dëmtuar duke pasur parasysh lëndimin emocional, fizik



dhe psikologjik të fëmijëve, e të mos merren parasysh rrethanat të cilat do të ulin dënimin e kryerësit.

Në krahasim me numrin e vogël të popullsisë dhe duke u bazuar në faktin se shumë raste nuk denoncohen, mbeten të fshehura, numri i kryerësve është relativisht i lartë. Që nga prezantimi i Regjistrimit (Qershor 2012) e deri më tani, janë publikuar gjithsej 257 persona. Sipas të dhënave nga regjistri pjesa dërrmuese e autorëve të krimeve të tilla janë të gjinisë mashkullore.

Megjithatë duhet të ndërmerren masa për njoftimin e të gjithë shtetasve të RMV sikurse në SHBA, pse jo edhe të vendosen dënime për personat të cilët dështojnë të regjistrohen në këtë regjistër. Identifikimi i kryerësve në shoqëri do të mundësojë parandalimin e shumë rasteve të abuzimit duke filluar nga personat që jetojnë në lagjen tonë apo që enden rrugëve në afërsi të shkollave apo parqeve të lojrave.

Mëngësi e shoqërisë tonë në këtë drejtim është mos denoncimi i këtyre rasteve. Ashtu si në shumë shtete të SHBA-ve procesi edukativ-arsimor duhet të përmbajë programe për njohjen e abuzimit seksual të fëmijëve, si të shmangim këto dukuri dhe si të përballemi me to. Edukimi i fëmijëve për denoncimin e rasteve të tilla duhet të jetë primar për çdo prind dhe çdo edukator. Fëmijët mund të flasin vetëm kur e ndjejnë se janë të rrethuar nga një mjedis i sigurtë, i cili e beson dhe e mbështet. Ato duhet të jenë të siguritë, se fakti që ka treguar se çfarë i ka ndodhur është gjëja e duhur. Një fëmijë që është afër me abuzuesin mund të ndjehet fajtor se ka zbuluar sekretin. Fëmija gjithashtu mund të ndjehet i frikësuar nëse abuzuesi e ka kërcënuar në rast se tregon sekretin.

Roli i medias, është padyshim një pjesë e domosdoshme e luftës për të parandaluar abuzimin seksual ndaj fëmijëve, megjithatë një publicitet jo i domosdoshëm për çështje të ndjeshme, mund t'i shkaktojë trauma më të mëdha viktimave, tashmë të shkatërruar prej abuzimit, si dhe familjeve dhe komuniteteve të tyre në përgjithësi. Pas evidentimit të personave të dënuar në regjistër është detyrë e medias, portaleve, rrjeteve sociale, etj. në përhapjen e këtyre lajmeve. Duke pasur një sistem të mirëfillt të denoncimeve dhe menaxhimit të mirë të regjistrimit, angazhimi i mediave duhet të jetë maksimal.

Prindërit duhet të edukojnë fëmijët që të kenë kujdes nga çdokush që ju afrohet, të bisedojnë haptaz me ato në lidhje me temën e abuzimit seksual, e në rastet kur abuzimi do të ndodh të jenë të gatshëm të tregojnë një gjë të tillë dhe të jenë të sigurtë se raportimi nuk do t'i dëmtojë ato. E rëndësishme është gjithashtu që fëmijët të edukohen edhe nëpër shkolla, nga që fatkeqësisht abuzimi ndodh edhe në hapsirat e shtëpisë nga anëtarët e afërm të familjes. Ndërsa fëmijët viktimë të abuzimit seksual kanë nevojë për ndihmë urgjente jo vetëm ndihmë profesionale, por edhe mbështetje personale dhe humane në mënyrë që ata të ndihen të sigurt, të fitojnë përsëri besimin tek njerëzit e tjerë, në mënyrë që përsëri të duan të jetojnë në një ambient social dhe thjesht të ndihen dhe të jenë përsëri fëmijë.

Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve kanë kontribuar jashtëzakonisht për ta bërë botën një vend më të sigurt për të jetuar. Megjithatë, ato kurrë nuk duhet të merren si të mirëqena dhe çdo brez duhet të kontribuojë në zhvillimin e tyre, t'i rishqyrtojë ato përsëri dhe të luftojë për to. Çështja e abuzimit seksual të fëmijëve paraqet një problematikë shoqërore, e cila duhet të identifikohet, abuzimi duhet të marrë fund ndërsa fëmijëve duhet tu ofrohet ndihmë profesionale.

Ndër rekomandimet të cilat patjetër duhet theksuar janë:

- Bashkëpunim i koordinuar dhe i vazhdueshëm i të gjitha institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare në parandalimin e abuzimit seksual të fëmijëve;
- Zhvillimi dhe financimi i programeve arsimore nëpër shkolla fillore dhe të mesme që ofrojnë njohuri mbi efektet e abuzimit seksual dhe rëndësinë e raportimit të këtij fenomeni;
- Shqiptimi i dënimeve më të larta për kryerësit, varësisht nga vepra dhe pasojat nga vepra e kryer;
- Të merren masa në informimin e publikut për ekzistimin dhe punën e Regjistrisë të veçantë të personave të dënuar për vepra penale të abuzimit seksual të personave të mitur dhe pedofili;
- Mirëmbajtja dhe azhurimi i vazhdueshëm i Regjistrisë;
- Trajnimi i personave të kualifikuar dhe specializuar që do të punojnë në mbrojtjen, shërimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të abuzimit seksual.

**Citimi i Kartës së Ambasadës të Parë të Fëmijëve në Botë – Megjashi <sup>102</sup>**

“Fëmijët janë popull i veçantë. Fëmijët nuk janë komandant kombëtar dhe fetar. Ato janë një popull i cili asnjëherë nuk kanë ngritur revolucion ose kundër revolucion, as edhe nuk kanë nxjerrur luftë. Fëmijët nuk janë as çështje kombëtare as klasore: fëmijët janë çështje mbi të gjitha çështjet. Ato janë popull i cili më tepër vuan në sulmet luftarake dhe tragjedive njerëzore. FËMIJËT JANË VETËM FËMIJË. TË GJITHA IDEALET E BOTËS JANË MË PAK TË RËNDËSISHME NGA LOTËT E NJË FËMIJE.”

---

<sup>102</sup> Citimi i Kartës së Ambasadës të Parë të Fëmijëve në Botë – Megjashi, <http://www.childrensembassy.org.mk/>

## Literatura e shfrytëzuar:

### 1. Libra, Artikuj shkencorë

- Zejneli.I, E drejta penale – pjesa e posaçme, Tetovë, 2007
- Zejneli.I, Sahiti.E, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017
- Netkova.B, Zejneli.I, Trafikimi me njerëz – aspekte juridike, Tetovë, 2006
- Kambovski.V, E drejta penale – pjesa e përgjithshme (përkthim), 2004
- Kambovski.V, & Zejneli.I, E drejta penale-Tetovë, 2018
- Kambovski.V, Komentar na Krivicniot Zakonik na Republika Makedonia, botimi i dytë, Matica, Shkup, 2015
- Salihu.I, E drejta penale, Prishtinë, 2015
- Salihu.I, E drejta penale – pjesa e posaçme, Prishtinë, 2015
- Elezi.I, E drejta penale – pjesa e posaçme, Tiranë, 2004
- Halili.R, Kriminologjia, Prishtinë, 2011
- Halili, Ragip, Viktimologjia, Prishtinë, 2011
- Osmani.A, Kodi penal (përkthyer në gj.shqipe), Shkup, 2015
- Murtezani. L, Psikologjia e zhvillimit, Tetovë, 2007
- Murtezani.L, Keqpërdorimi i fëmijëve në kulturat e ndryshmeve, Tetovë, 2009
- Dragoti. E, Hyrje në punë sociale, Tiranë, 2009
- Avziu.Q, Hyrje në kriminalistikë, Tetovë, 2015
- Latifi.V, Kriminalistika- Zbulimi dhe të provuarit e krimit, Botimi i gjashtë, Prishtinë, 2009
- Latifi.V, Politika Kriminale, Prishtinë, 2011
- Haxhiymeri.E, et.al., “Abuzimi i fëmijëve në familje” Tiranë, 2005
- Sulejmanov.Z, Makedonska Kriminologjia, Shkup, 2000
- Sllamkov.Gj, Ligji penal - Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2009
- Ukaj.B, Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006

- Muratbegović.E, Parandalimi i kriminalitetit (Compendium of Crime Prevantion and Crime Control), Sarajevë/Prishtinë, 2007
- Ratkoceri.V, Phd, Kastrimi kimik si sanksion penal, 2018, marrë nga: [https://library.seeu.edu.mk/index.php?lvl=search\\_result](https://library.seeu.edu.mk/index.php?lvl=search_result)
- Ratkoceri.V, Criminal policy of Republic of Macedonia for combating and preventing sexual abuse of children, Proceedings of the 11th South East European Doctoral Student Conference, 2017
- Ratkoceri.V, Regjistri i pedofilisë në Repubëikën e Maqedonisë, Konferenca e parë shkencore e studentëve të fakultetit të drejtësisë në UEJL,Tetovë, 2017
- Strategjia Kombëtare (2020-2025) dhe Plani i Veprimit (2020-2022) për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna, dhjetor, 2019, marrë nga: <http://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nspX>, qasja e fundit: 10.01.2020
- Çaçeva.V, & Mirceva.S, Të braktisur e të damkosur: Analiza e gjendjes: Abuzimi seksual i fëmijëve, 2010, Shkup: Zyra e UNICEFit
- Sostojbata na decata na svetot, UNICEF, MK, 2009
- Studija za trgovija so deca vo Makedonija (neobjaveno), UNICEF, MK, 2007
- Kam të drejtë, UNICEF, IHSPJ, Maqedoni, 2004
- Avokati i Popullit, Raport nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, Shkup, 2012
- Shehu. E & Gramo.A, Dhuna me bazë gjinore-Manual për punonjësit e mjeksisë., marrë nga: [http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania\\_Manual%20for%20health%20workers%20in%20Albanian.pdf](http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania_Manual%20for%20health%20workers%20in%20Albanian.pdf), qasja e fundit 13.02.2020
- Raport tematik: Dhuna tek fëmijët vajza, Lidhja kombëtare e ndihmës për fëmijët, Tiranë, 2013
- Hazizaj. A, Ibrahimllari. E, Manual për Njësitë e Mbrojtjes së Femijëve “Për Mbrojtjen e Femijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi nëpërmjet internetit”, CRCA Shqipëri, 2016, marrë nga: <https://www.isigurt.al/sites/default/files/downloads/Manuali%20CPU-ve.pdf>, qasja e fundit 13.02.2020

- Kambovski.V, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2015
- Salihu.I, Zhitija.H, Hasani.F, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, marrë nga:  
<https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2015/06/udh%C3%ABzuesi-31.pdf>,  
qasja e fundit 17.02.2020
- Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin me Abuzimin Seksual të Fëmijëve dhe Pedofilisë, 2009-2012, marrë nga:  
<http://mtsp.gov.mk/?ItemID=BD66FCC3A7FBCB47AB9150CBFECD2C96>, qasja e fundit 10.01.2020
- Petrovska. N, et. al., Prind i drejt, fëmija e drejt, Skopje - UNICEF, 2019, marrë nga:  
<https://www.unicef.org/northmacedonia/sites/unicef.org.northmacedonia/files/2019>,  
qasja e fundit 12.02.2020
- Mr. Popevski.S, Të miturit viktimë të veprave penale si kategori e marginalizuar në shoqërinë tonë, publikuar nga Instituti për të drejtat e njeriut, Shkup, marrë nga:  
<https://www.ihr.org.mk/p.php?pid=290>, qasja e fundit 20.01.2020
- Zymeri. T, et. al., Siguria e fëmijëve në internet: udhëzues për fëmijë, Kosovë, marrë nga:  
<http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/Siguria-e-femijeve-ne-internet-Udhezues-per-Femije.pdf>, qasja e fundit 15.01.2020
- Haxhiymeri. E, et. al., Abuzimi në familje, Tiranë, 2005
- Lenja. V, Profili i situatave të viktimave të trafikimit dhe përpjekjet për përfshirje sociale, Tiranë, 2015, marrë nga:  
[https://publications.iom.int/system/files/pdf/social\\_inclusion\\_albania\\_alb.pdf](https://publications.iom.int/system/files/pdf/social_inclusion_albania_alb.pdf), qasja e fundit 22.01.2020
- Roli, Detyrat, Përgjegjësitë për një shërbim social të përshtatshëm ndaj qytetarit – RIDE, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Tiranë, 2013, marrë nga:  
[https://observator.org.al/wpcontent/uploads/2014/01/Alb\\_Policy\\_Study\\_Children\\_in\\_treet\\_situation\\_23-January\\_2014.pdf](https://observator.org.al/wpcontent/uploads/2014/01/Alb_Policy_Study_Children_in_treet_situation_23-January_2014.pdf), qasja e fundit 13.01.2020

- Brent E. Turvey, Criminal Profiling (Fourth Edition), 2012, marrë nga: <https://www.sciencedirect.com/topics/social-sciences/child-molestation>, qasja e fundit 03.01.2020
- MacFarlane. K, et. al., Sexual abuse of young children, New York, 1987
- Sgroi, Suzanne M., Handbook of clinical intervention in child sexual abuse, Canada, 1989
- Vandenhoeck & Ruprecht, Werner Hilweg/Elisabeth Ullmann (Hg): Kindheit und Trauma, Göttingen, 1997, 1999
- Heinze.E, Of innocence and autonomy, United Kingdom, 2000
- Bell. P. A, The personality of a child molester, USA, 1971
- Walker.A, The color purple, New York, 1985
- Seabrook.J, No hiding place: Child Sex Tourism and the Role of Extraterritorial Legislation, 2000
- Griffin.L, & Blacker.K, Megan's Law and Sarah's Law: A Comparative Study of Sex Offender Community Notification Schemes in the United States and the United Kingdom, 46 Crim. L. Bull. 987, 2010
- Kinnear L. Karen, Childhood sexual abuse: a reference handbook, California, 2007
- Duncan A. Karen, Healing from the Trauma of Childhood Sexual Abuse: The Journey for Women, 2004
- Rowan L. Edward , Understanding Child Sexual Abuse, University of Mississippi, USA, 2006
- Kielsingardf.M, Myth-driven state policy: an international perspective of recidivism and incurability of pedophile offenders, 2014
- Vandiver.D, et.al., Sex Crimes and Sex Offenders – Research and Realities, New York, 2017
- National Center for Missing & Exploited Children, 1992, Child Molesters: A Behavioral Analysis, marrë nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/Digitization/149252NCJRS.pdf>, qasja e fundit 04.01.2020

- The Economist Intelligence Unit Limited 2019, Out of the shadows: Shining light on the response to child sexual abuse and exploitation, supported by World Childhood Foundation and the Oak Foundation. <https://outoftheshadows.eiu.com/wp-content/uploads/2019/01/Out-the-Shadows-Whitepaper.pdf>, qasja e fundit 23.01.2020
- United Nations Children’s Fund, INSPIRE Indicator Guidance and Results Framework - Ending Violence Against Children: How to define and measure change, UNICEF, New York, 2018
- Global Overview of Sex Offender Registration and Notification Systems, 2014 <https://www.smart.gov/pdfs/GlobalOverview.pdf>, qasja e fundit 05.01.2020
- Marie Swain, Registration of paedophiles (NSW Parliamentary library research service), Briefing Paper No 12/97
- Sex Offender Registration Map, (2018), National Center for Missing and Exploited Children
- Lipscombe. S, Sarah’s law: the child sex offender disclosure scheme, 2012
- Meredith G. F. Worthen Sexual Deviance and Society: A sociological examination, 2016, marrë nga: <https://minivannewsarchive.com/politics/one-in-seven-children-of-secondary-school-age-suffered-sexual-abuse-in-the-maldives-39063>, qasja e fundit 11.01.2020

**Tekste ligjore:** Kushtetuta, Kode, ligje, Konventa:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.91/2001
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/06, 73/06, 7/08, 39/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14 dhe 132/14
- Ligji për Procedurë Penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.150/ 2010
- Ligji për Regjistrin e veçantë të personave të dënuar për krime të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.11/2012, 112/2014



- Ligji për drejtësi për fëmijët, neni 145, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.148/2013
- Ligji për të drejtat e të miturve, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.87/2007, nr.145/2010
- Ligji për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Eksploatimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 135/2010
- Ligji për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 150/1993
- Ligji për Ekzekutimin e sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 166/2014.
- Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, Gazeta Zyrtare e R. Kosovës, nr.14/2019
- Deklaratë për internet më të sigurt, 2010, bazuar në nenin 68 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, neni 19, 1989
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, Lanzarote, 2007
- Këshillit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Gjenevë, 1999
- Ligji për ndëshkimet e rrepta ndaj abuzuesve seksual të fëmijëve, neni 77, 2009, Maldivet
- Ligji për dispozita të veçanta që ka të bëjë me kryerësit e abuzimit të seksual të fëmijëve, neni 57, Maldivet, 2009
- Protokollin i mbrojtjes së fëmijës, Shqipëri, 2009

### **Të dhëna statistikore:**

- Kryerësit e veprave penale në 2017, Entit shtetëror të statistikës, [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk), qasja e fundit 16.01.2020
- Të dhëna statistikore për abuzuesit seksual në RMV, [www.registarnapedofili.com](http://www.registarnapedofili.com), qasja e fundit 03.03.2020
- Të dhëna statistikore nga Ministria e Politikës dhe Punës Sociale.
- Të dhëna statistikore për abuzuesit seksual në Korenë e Jugut, marrë nga:

<https://www.wired.com/2001/08/korea-puts-sex-offenders-online/>, qasja e fundit 27.01.2020

- Që sot të dhënat e pedofilëve të gjykuar në internet, marrë nga: <https://vlada.mk/node/3347>, qasja e fundit 13.02.2020
- Vendim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Y.6p.86/2012, marrë nga: <http://ustavensud.mk/?p=10995>, qasja e fundit 05.03.2020

### **Burime nga interneti:**

- [www.registarnapedofili.com](http://www.registarnapedofili.com), Faqja online e Regjistrimit të veçantë të personave të dënuar për krime të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofili
- [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk), Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
- [www.library.seeu.edu.mk](http://www.library.seeu.edu.mk), Biblioteka online e Universitetit të Evropës Juglindore
- [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk), Enti shtetërorë i statistikës në RMV
- [www.vlada.mk](http://www.vlada.mk), Faqja zyrtare e qeverisë së RMV
- [www.ustavensud.mk](http://www.ustavensud.mk), Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese në RMV
- <https://www.worldvision.al/programet-tona/mbrojtja-e-femijeve>, Organizata World Vision në Programin e Mbrojtjes së fëmijëve, Shqipëri dhe Kosovë
- [www.ecpat.org](http://www.ecpat.org), Organizatat për eliminimin prostitucionit të fëmijës, pornografisë për fëmijë dhe trafikim i fëmijë për qëllime seksuale
- <https://www.living-democracy.al/>, Universiteti i Edukimit të Mësuesve në Zyrih (PH Zurich)
- <https://klaaskids.org/megans-law/>, Megan's law by state
- [www.fresnosheriff.org](http://www.fresnosheriff.org), Fresno County Sheriff's Office
- <https://www.history.com/this-day-in-history/adam-walsh-is-abducted>, Six-year-old Adam Walsh is abducted
- <https://www.romper.com/p/what-is-the-wetterling-act-jacob-wetterlings-legacy-helped-make-the-world-a-little-safer-17752>, What Is The Wetterling Act? Jacob Wetterling's Legacy Helped Make The World A Little Safer

- <https://www.psychiatry.org/psychiatrists/practice/dsm>, Të dhëna nga Manualit Diagnostik dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore nga Asociacioni Psikiatrik Amerikan (DSM-5)
- [http://www.childrensembassy.org.mk/newsletter-34-ns\\_article-interview-dragi-zmijanac-ma-sc-executive-director-and-founder-of-the-first-children-s-embassy-in-the-nspj](http://www.childrensembassy.org.mk/newsletter-34-ns_article-interview-dragi-zmijanac-ma-sc-executive-director-and-founder-of-the-first-children-s-embassy-in-the-nspj), Intervista e Dragi Zmijanac Ambasadës së parë të fëmijëve - MEGJASHI
- <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>, Konventa për të drejtat e fëmijëve, 1989
- <https://www.keepingchildrensafe.org.uk/sites/default/files/KCS%20Tool%203%20Albanian.pdf>, Manuali – Kush abuzon!?
- <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-children>, Violence against children,
- <https://www.pbc2019.org/protection-of-minors/child-abuse-on-the-global-level>, Të dhëna në nivel global për abuzimin seksual të fëmijëve
- <https://www.policechiefmagazine.org/sexual-violence-stopping-child-sexual-abuse/>, Magazine about Sexual Violence: Stopping Child Sexual Abuse
- [http://www.childmolestationprevention.org/pages/focus\\_on\\_the\\_cause.html](http://www.childmolestationprevention.org/pages/focus_on_the_cause.html), An Ongoing Sex Drive Directed Toward Children
- <https://www.coe.int/en/web/children/lanzarote-convention>, Konventa e Lanzarotes
- <https://www.wired.com/2001/08/korea-puts-sex-offenders-online/>, Korea Puts Sex Offenders Online
- <http://www.ncjrs.gov/App/publications/abstract.aspx?ID=210600>, National criminal justice reference service
- <http://www.offenders.mv/> Child sex offender registry, Maldives
- <http://agoffice.gov.mv/pdf/sublawe/CSAO.pdf>, Ligji për dispozita të veçanta që ka të bëjë me kryerësit e abuzimit të seksual të fëmijëve, Maldive